



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.02.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, për vitin 2022”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 13:24.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Irena Plaku** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado** (anëtar)
- 7. Alban Toro** (anëtar)
- 8. Marçela Shehu** (anëtare)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtare)
- 10. Yllka Rupa** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
- 6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 8. Albana Boksi, Këshilltar për Etikën në gjykata.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, për vitin 2022”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Përsëritje!

Fillojmë mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 23 shkurt.

Siç jeni në dijeni, sot nga ana e Këshillit do të merren në shqyrtim rreth 6 çështje.

Pa humbur kohë po fillojmë me çështjen e parë.

Pra, sot në mbledhje do të miratohen raportet e secilit nga komisionet e përhershme të Këshillit.

Çështja e parë ka të bëjë me raportimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, për vitin 2022.

Në cilësinë e kryetares së këtij Komisioni, shkurtimisht dëshiroj të informoj kolegët që në respektim të pikës 16, të nenit 62 të Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ku përcaktohet që secili nga komisionet e

përhershme paraqet në mbledhjen plenare të Këshillit raportin vjetor të veprimtarisë me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, raport i cili mbart detyrimin që të bëhet publik të faqen zyrtare të Këshillit, paraqesim për shqyrtim dhe miratim sot në këtë mbledhje plenare, raportin vjetor të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit për vitin 2021 (lapsus, për vitin 2022).

Në fund të vitit 2021, në përputhje me detyrimin e parashikuar nga ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” u krye dhe ndryshimi i përbërjes së Komisioneve të përhershme të Këshillit, nga ku dhe përbërja e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Tashmë është me një përbërje të ndryshme:

- Znj. Naureda Llagami, Kryetare
- Znj. Marçela Shehu, anëtare
- Znj. Fatmira Luli, anëtare
- Znj. Brikena Ukperaj, anëtare zëvendësuese
- Znj. Yllka Rupa, anëtare zëvendësuese

Komisioni e vlerëson momentin e hartimit të raportit vjetor të veprimtarisë së tij jo thjesht si një detyrim ligjor apo transparencë ndaj publikut. Por, ai e sheh hartimin e raportit si një moment bilanci ku vlerësohen sfidat dhe arritjet, vështirësitë dhe rreziqet si dhe shihen mundësitë që e ardhmja sjell për të ndërmarrë më shumë, për të bërë më mirë dhe për të shkuar më pranë standardeve të ekselencës gjyqësore që Këshilli proklamon dhe kërkon për sistemin gjyqësor shqiptar.

Viti 2022, mund të përshkruhet si një vit më i mirë se ai i lënë pas, kjo dhe për faktin se ai përkon me zhdukjen graduale të pandemisë globale COVID-19. Megjithatë, sfidat për sistemin gjyqësor nuk kanë përfunduar kur bëhet fjalë për mungesën e burimeve njerëzore nëpër gjykata, veçanërisht më të prekura janë gjykatat e apelit, për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar. Rrjedhimisht, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ka vazhduar veprimtarinë e tij me qëllim reagimin në kohë dhe në përputhje me vizionin e tij strategjik për sa i përket problematikave të hasura në sistemin gjyqësor.

Si për çdo vit, raporti vjetor ofron një përshkrim të detajuar dhe shterues të veprimtarisë së Komisionit, e shprehur përmes analizimit të vendimmarrjeve të tij në

fushën e planifikimit strategjik, administrimit dhe buxhetit. Veprimtaria e Komisionit ilustron në mënyrë kualitative dhe kuantitative, duke nxjerrë në pah jo vetëm volumin e punës, por mbi të gjitha vendimmarrjet më të rëndësishme, sidomos në aspektin e miradministrimit të sistemit gjyqësor nga pikëpamja e efikasitetit dhe transparencës, projekteve dhe zhvillimeve në infrastrukturën teknologjike, si dhe politikave financiare dhe buxhetore. Që në hyrje të raportit, lexuesi njihet me pasaportën e arritjeve të Komisionit të cilat kanë shënuar rrugëtimin e tij gjatë vitit që shkoi, të cilat elaborohen në mënyrë të shtjelluar gjatë analizës së vendimmarrjeve. Krahas sfidave me të cilat Komisioni është ndeshur gjatë vitit 2021, raporti ofron edhe një set angazhimesh për të ardhmen, të cilat do të jenë busulla orientuese për veprimtarinë e Komisionit në vitin e ardhshëm.

Sikurse është përmendur edhe në raportet e mëparshme vjetore, kuadri ligjor i ka atribuar këtij Komisioni kompetenca të rëndësishme në tre nivele:

I. Nivelin Strategjik, në funksion të të cilit Komisioni ndërmerr iniciativa strategjike, qoftë edhe në nivele “ad hoc”, për adresimin në kohën e duhur dhe me mjetet e përshtatshme, të dinamikave të ndryshme me të cilat ballafaqohet Këshilli dhe sistemi gjyqësor.

II. Nivelin Administrativo – menaxherial, kompetenca këto që lidhen me rregullimin e brendshëm të gjykatave nga pikëpamja e burimeve njerëzore, infrastrukture dhe pasurive të paluajtshme/aseteve duke përcaktuar standardet etiko–profesionale të nëpunësve civilë gjyqësorë, me qëllim garantimin e një sistemi funksional dhe eficient.

III. Nivelin e politikave buxhetore dhe financiare, funksion i cili del në pah veçanërisht gjatë procesit të planifikimit të projektbuxhetit afatmesëm (PBA), negocimit dhe monitorimit të zbatimit të këtij buxheti, me qëllim jo vetëm garantimin e standardeve të menaxhimit financiar, por edhe vlerësimit të situatës financiare dhe buxhetore të Këshillit dhe sistemit gjyqësor. Në kuadër të kësaj kompetence ligjore, komisioni është përgjegjëse edhe për hartimin, miratimin dhe monitorimin e politikave buxhetore dhe financiare për Këshillin dhe sistemin gjyqësor, duke garantuar burimet e nevojshme financiare në kuadër të mbarëvajtjes së funksionalitetit, jo vetëm të Këshillit, por edhe gjykatave në vend.

Ky Komision, në ushtrimin e kompetencave të veta, sikurse vihet re nga sa më lart, luan një rol të qenësishëm në përmbushjen e misionit madhor të Këshillit të Lartë Gjyqësor në qeverisjen, mbarëvajtjen dhe mirëadministrimin.

Komisioni si struktura përgjegjëse për hartimin, miratimin dhe monitorimin e zbatimit të planit strategjik, politikave administrative, financiare dhe buxhetore në funksionin të menaxhimit të mirë e efikas të sistemit gjyqësor në vend, gjatë vitit 2022 ka realizuar 40 mbledhje, në të cilat janë marrë 100 vendime, 88 prej të cilave në fushat përkatëse të veprimtarisë si më poshtë vijon:

- 22 në fushën e planifikimit strategjik;
- 46 në fushën e administrimit dhe efijencës;
- 18 në fushën e planifikimit dhe menaxhimit financiar dhe buxhetor;
- 2 akte individuale (konfidenciale).

12 vendimmarrje të Komisionit i referohen miratimit të procesverbaleve të mbledhjeve plenare, në përputhje me detyrimin ligjor që ka Këshilli përkundrejt transparencës në marrëdhëniet me publikun. Përmes faqes së internetit të Këshillit, ky detyrim është përmbushur brenda afateve ligjore të arsyeshme, duke kontribuar në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së punës së KLGJ-së, përkundrejt qytetarëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar.

Vendimmarrjet e Komisionit dëshmojnë angazhim për të reaguar në kohën e duhur dhe me mjetet e nevojshme ndaj problematikave të evidentuara në sistemin gjyqësor, kjo dhe në kuadrin e miratimit të hartës së re gjyqësore e cila riorganizon shtrirjen e gjykatave në vend.

Duke qenë se një pjesë e madhe e vendimmarrjeve, janë të rëndësishme në kuadrin e mirëadministrimit të gjykatave dhe ndërtimit të një administrate gjyqësore profesionale, Komisioni ka bashkëpunuar ngushtë me komisionet e tjera të përhershme të Këshillit, aktiviteti i të cilave është i ndërvarur dhe me veprimtarinë dhe funksionet e tyre. Ky bashkëpunim vjen në funksion të bashkërendimit të angazhimeve për garantimin e ekselencës së sistemit gjyqësor.

Disa prej arritjeve më të spikatura të Komisionit gjatë vitit 2022 janë:

- 89 akte të hartuara dhe miratuara.

- Miratimi i Planit të ri Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor për sistemin gjyqësor në Shqipëri për vitin 2022–2024, i shoqëruar me një sërë aktesh me qëllim rritjen e transparencës dhe një komunikim më të mirë e cilësor me publikun dhe median.

- Rritja e efikasitetit të gjykatave të apelit nëpërmjet shtimit të stafit administrativ dhe mbështetjes teknike në sistemin e menaxhimit të çështjeve.

- Vazhdimi i zbatimit të reformës për nëpunësin civil gjyqësor përmes kualifikimit për emërim në shërbimin civil gjyqësor të 15 punonjësve në sistem, me fokus të veçantë mbështetjen me burime njerëzore të gjykatave të apelit: 10 ndihmës ligjorë në gjykatat e apeleve dhe 5 këshilltarë ligjorë pranë njësisë ligjore të Gjykatës së Lartë.

- Standardizimi dhe përmirësimi i sistemit të llogaridhënies së nëpunësve civilë gjyqësorë, konkretisht kancelarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë, përmes miratimit të rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor”.

- Realizimi i buxhetit për sistemin gjyqësor (KLGJ-ja dhe gjykatat) në masën 93%, duke reaguar në mënyrë të shpejtë dhe të drejtë ndaj nevojave të sistemit gjyqësor.

- Rritja e transparencës dhe efikasitetit për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit përmes përmirësimeve të sistemeve aktuale gjyqësore: ICMIS dhe ARKIT.

i) Mundësimi i zhvillimeve të reja si dhe trajtimi i 686 kërkesave për mbështetje teknike.

ii) Përfundimi me sukses i migrimit të gjithë bazës së të dhënave të 5 gjykatave të mëparshme të apelit në Gjykatën e Apelit për Juridiksionin e Përgjithshëm mundësuar në kuadër të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore.

iii) Ngritja e infrastrukturës së re fizike e cila do të mundësojë administrimin dhe përpunimin e të gjitha çështjeve të Gjykatës së Apelit për Juridiksionin e Përgjithshëm.

iv) Përcaktimi i rregullave të hollësishme për ndarjen e çështjeve me short dhe zbatimin e tyre, marrja e masave të nevojshme, si dhe testimi i këtij mekanizmi për të mundësuar realizimin me sukses në praktikë.

- Sigurimi i mirëfunksionimit të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit dhe miratimi i të gjitha akteve të nevojshme në këtë drejtim, përfshirë miratimin e strukturës dhe organikën e saj.

Në kuadrin e kryerjes së bilancit të fundvitit 2022 dhe në njohje të plotë të rolit dhe funksioneve të tij, Komisioni do të vazhdojë punën e tij me përgjegjësi e përkushtim dhe përgjatë vitit 2023 duke marrë angazhimet si më poshtë vijon:

1. Vijimin e hartimit të kuadrit nënligjor të nevojshëm për të gjitha proceset dhe çështjet me fokus planifikimin strategjik, administrimin dhe buxhetin e sistemit gjyqësor, si dhe ato që lidhen me veprimtarinë dhe mirëfunksionimin e gjykatave, Këshillit dhe vetë Komisionit.

2. Vazhdimin e zbatimit të reformës për nëpunësin civil gjyqësor me qëllim krijimin e një administrate të qëndrueshme dhe finalizimit të paketës së akteve të nevojshme për mirëfunksionimin e administratës civile gjyqësore.

3. Hartimin e kërkesave buxhetore realiste si për vitin e ardhshëm dhe për buxhetin afatmesëm të sistemit gjyqësor në përputhje dhe me planin e zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore.

3.1 Sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm me qëllim identifikimin e nevojave për burime njerëzore dhe financiare nëpër gjykata.

4. Menaxhimin e fondeve buxhetore të alokuara me efikasitet dhe efektivitet për KLGJ–në dhe ndjekje e monitorim të tyre.

5. Ndjekjen e nevojave të sistemit gjyqësor për mirëmbajtjen dhe sigurinë e sistemit aktual të menaxhimit të çështjeve.

6. Forcimi i bashkëpunimit me donatorët dhe projektet e ndihmës së huaj me qëllim sigurimin e fondeve të nevojshme për zhvillimin e një sistemi të ri e bashkëkohor të teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë dhe çështje të tjera.

Për më shumë informacion mbi aspekte të ndryshme të veprimtarisë së Komisionit, i keni më të detajuara në raportin bashkëlidhur këtij relacioni.

Naureda Llagami: Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në miratimin e raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, për vitin 2022.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, për vitin 2022” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.02.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e raportit mbi veprimtarinë e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për vitin 2022”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 13:24.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
7. **Albana Boksi, Këshilltar për Etikën në gjykata.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e raportit mbi veprimtarinë e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për vitin 2022”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e raportit mbi veprimtarinë e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për vitin 2022”. Fjalën ia jap zotit Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organ qeverisës i gjyqësorit, ka mandatin ligjor për të “siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor”. Në kuadër të tij Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ushtron rolin e tij, ndër të tjera, duke përgatitur procesin e përzgjedhjes/emërimit, promovimit, transferimit mbi bazën e kualifikimit profesional dhe integritetit personal, edhe nëpërmjet kohëzgjatjes së ushtrimit të funksionit e sigurisë financiare, pavarësisë në vendimmarrje, si dhe garantimit të drejtave vetjake të gjyqtarit. Çdo projektvendim i paraqitur në lidhje me emërimin apo karrierën e gjyqtarëve ka qenë i bazuar në kritere objektive të përcaktuara nga ligji për statusin.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, përgjatë vitit 2022, ka përmbushur një sërë detyrash të rëndësishme që i përkasin fushës së veprimtarisë së tij, por edhe një sërë detyrash që lidhen me prioritetet e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si Këshilli).

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (në vijim referuar si KZHK ose Komisioni) ka pasur në fokus ndjekjen e procesit të plotësimit të vendeve vakante në gjykata përmes skemës së delegimit, transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve, ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, si dhe ka shqyrtuar kërkesat e paraqitura nga drejtuesit e gjykatave në lidhje me caktimin e gjyqtarëve të ndryshëm për shqyrtimin e çështjeve të veçanta. Gjithashtu, Komisioni ka përmbushur detyrimet ligjore në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës për caktimin e numrit të magjistratëve të rinj.

Pasur parasysh, Synimin 1 të Strategjisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni pati prioritet përmbylljen sa më shpejt të kuadrit ligjor për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, pozicione të lira në të tre fushat e së drejtës: penale, administrative dhe civile. Në këtë mënyrë, Këshilli iu përgjigj edhe Rekomandimit nr. 1 të Rezolutës së Kuvendit për KLGJ-në. Gjithashtu, prioritet ka qenë edhe plotësimi i pozicioneve të lira pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, por për shkak të mungesës së kandidatëve për ngritjen në detyrë pranë këtyre gjykatave, Këshilli në këtë mënyrë hapi dhe rihapi procedurat e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Përveç sa më sipër, në kushtet kur nëpër gjykatat e të gjitha niveleve vijon boshatisja për shkak të efekteve të procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe ekzistojnë pengesa të ndryshme për plotësimin e tyre me gjyqtarë, Komisionit i është dashur të delegojë një numër të lartë gjyqtarësh, me qëllim zhblokimin e situatës dhe garantimin e dhënies së drejtësisë për individët.

Mbi procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Referuar Synimit 1 të Planit Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor për Sistemin Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë, prioritet emergjent është bërja funksionale e Gjykatës së Lartë. Pas realizimit të emërimit të tre anëtarëve në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, me anë të Dekreteve nr. 11452, 11453 dhe 11454, datë

11.03.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Këshilli, përgjatë vitit 2022, vijoi me procedurën për pozicion e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 172 datë 11.09.2019, në fushë e së drejtës civile.

Pas kryerjes së veprimeve procedurale dhe verifikuese të relatorit përkatës, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, u miratua vlerësimi dhe pikëzimi paraprak i kandidatit që konkurren për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në fushën e së drejtës civile, me vendimin e Këshillit nr. 172, datë 11.09.2019. Më pas, me vendimin e Këshillit nr. 103, datë 25.03.2022, u miratua vlerësimi dhe pikëzimi përfundimtar i kandidat {...}. Më tej procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, vijoi me miratimin nga Këshilli të vendimit nr. 132, datë 06.04.2022, për renditjen e kandidatëve që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019. Pas kësaj, procedura e përzgjedhjes së gjyqtarëve për në Gjykatën e Lartë, u finalizua me vendimin nr. 133, datë 06.04.2022, me anë të të cilit u propozua emërimi në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, për kandidatin e renditur më lart. Në përfundim, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me anë të Dekretit nr. 13573, datë 26.04.2022, emëroi kandidatin e propozuar nga Këshilli, si gjyqtar të Gjykatës së Lartë.

Përfundime në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur gjatë vitit 2022, ku rezulton se janë miratuar: 3 (tre) vendime/akte administrative individuale që i përkasin procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të cilat u finalizuan me dekretimin nga Presidenti i Republikës të kandidatit të propozuar nga Këshilli, si gjyqtar i Gjykatës së Lartë.

Procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve:

Komisioni ka hapur një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, për shkak të përfundimit të mandatit të z. {...} të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022, duke përcaktuar dhe afatin dyjavor të kandidimit për këto procedura.

Secili vendim është i ndarë në katër krerë, ku në Kreun I përcaktohet hapja e procedurës, në Kreun II përcaktohet afati i kandidimit, në Kreun III Informacioni dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet kandidimit [...].

Në përfundim të afatit të kandidimit, mbi propozimin e KZHK-së, Këshilli me vendimin nr. 26, datë 17.01.2022 dhe me vendimin nr. 220, datë 20.06.2022, ka filluar procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë dhe përcaktimin e relatorëve përkatës për katër pozicionet e shpallura me vendimet nr. 535, nr. 536, dhe nr. 537, datë 17.11.2021 dhe pozicion e shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022.

Ndërkohë, për t'i hapur rrugë kryerjes së vlerësimeve etike dhe profesionale të kandidatëve, si element kyç i përcaktuar nga ligji për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve sipas meritokracisë, Këshilli ndau në dy pjesë procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit. Në pjesën e parë, u verifikuan tre kriteret formale të kandidimit, pikërisht ai i “përvojës profesionale minimale”, i “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe i “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” .

Ndërkohë, rezultoi që një nga kandidatët që kandiduan në procedurat e ngritjes në detyrë nuk kishin kaluar ende procesin e rivlerësimit kalimtar, ndaj, për këtë kandidat, Këshilli i kërkoi Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar si KPK) trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar për të.

Duhet theksuar se kërkesa për trajtimin me përparësi është bërë sipas vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

Ky përcaktim në këtë akt nënligjor është bërë në funksion të shmangies së një kontrolli të dyfishtë për këtë kategori kandidatësh, duke konsideruar se kushtetutëbërësi ka konsideruar si të domosdoshëm dhe parësor rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve.

Po ashtu, kërkesa për trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar për kandidatin është bërë edhe duke pasur në konsideratë Rregulloren e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Referuar sa më lartë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi ka marrë në shqyrtim në seancë dëgjimore, më datë 21.11.2022, çështjen në ngarkim të subjektit të

rivlerësimit {...}, me vendimin përkatës ka vendosur: Konfirmimin në detyrë të subjektit, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Pas verifikimit, mbi propozimet e relatorëve, Këshilli ka miratuar 11 (njëmbëdhjetë) akte administrative individuale për plotësim e tre prej kritereve ligjore të kandidimit për në Gjykatën e Lartë, duke vijuar me procesin e vlerësimit etik dhe profesional, procese që janë duke u zhvilluar nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Në këtë mënyrë, mbi propozimet e relatorëve, Këshilli ka miratuar 11 (njëmbëdhjetë) akte administrative individuale për kualifikimin e kandidateve për në Gjykatën e Lartë dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet përkatëse, 1 (një) akt administrativ individual për skualifikimin e kandidatit z. {...} dhe përjashtimin nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet përkatëse.

Ndërkohë, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve, pati edhe tërheqje nga kandidimi nga disa kandidatë, e për rrjedhojë, mbi propozimet e relatorëve, Këshilli ka miratuar 2 (dy) vendime për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë të kandidatëve, në pozicionet respektive.

Komisioni i ka propozuar KLGJ-së miratimin e projektvendimit në lidhje me fillimin e procedurave të përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 536, nr. 537, datë 17.11.2021, si dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022 si dhe caktimin e relatorit për secilën procedurë përzgjedhjeje.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, për kandidatët e Gjykatës së Lartë nga radhët e gjyqtarëve, relatori i procedurës së përzgjedhjes, vijoi me propozimin për renditje të gjyqtarëve në Gjykatën Lartë për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimet nr. 82, nr. 83, nr. 84, datë 26.02.2020, me propozimin për renditje të gjyqtarëve në Gjykatën Lartë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimin nr. 85, nr. 86, datë 26.02.2020. Pas

miratimit nga Këshilli të renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe administrative, relatori i çështjes përcolli për miratim propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe z. {...}.

Përfundime në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, gjatë vitit 2022, nga ku rezulton të jenë miratuar:

- 1 (një) akt administrativ kolektiv për hapjen e procedurave për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve.

- 4 (katër) akte administrative kolektive nga të cilët 2 (dy) akte për fillimin e procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë dhe 2 (dy) akte për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve për pozicionet e shpallura të lira;

- 2 (dy) akte administrative individuale me anë të të cilave Këshilli ka disponuar përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë të kandidatit, për pozicionin përkatës, për shkak të tërheqjes nga kandidimi;

- 1 (një) akt administrativ individual për skualifikimin e kandidatit për në Gjykatën e Lartë dhe përjashtimin i tij nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë;

- 22 (njëzet e dy) akte administrative individuale nga të cilat 11 (njëmbëdhjetë) akte për plotësim të tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë dhe 11 (njëmbëdhjetë) akte për kualifikimin e kandidatëve për në Gjykatën e Lartë dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet përkatëse;

- 5 (pesë) akte administrative kolektive për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimet nr. 82, nr. 83, nr. 84, datë 26.02.2020, për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 85, nr. 86, datë 26.02.2020.

- 5 (pesë) akte administrative individuale për miratim propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë.

Për gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar:

Një nga arritjet e reformës në drejtësi ishte krijimi i gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar. Sipas Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, për

vitin 2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të plotësojë vendet vakante në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Pra, promovimi i gjyqtarëve pranë këtyre gjykatave vijon të jetë një nga Rekomandimet që Kuvendi i Shqipërisë kishte për KLGJ-në për vitin 2022.

Procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar:

Sipas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 286, datë 18.12.2019, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të kësaj gjykate është 11 (njëmbëdhjetë), ashtu siç përcakton Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Këshilli ka hapur dhe rihapur procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve edhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shtatë pozicione të lira, për disa prej të cilave nuk u paraqit asnjë kandidaturë, ndërsa për pozicionin nr. 30, datë 25.01.2021, për pozicionet e lira nr. 117–119, datë 01.04.2021, Këshilli vijoi procedura ngritje në detyrë për kandidatët që kandiduan. Për pozicionet e lira sa më sipër kandiduan 3 gjyqtarë. Secili vendim është i ndarë në katër krerë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, mbi propozimin e KZHK-së, Këshilli me vendimin nr. 77, datë 04.03.2021, me vendimin nr. 178, datë 29.04.2021 ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore dhe pas shortit të hedhur, ka caktuar edhe relatorët për secilin kandidat. Për kandidatët që kandiduan në procedurat e ngritjes në detyrë është vijuar me verifikimin e kritereve, që janë: i) “pasja e përvojës profesionale minimale”; ii) “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake; iii) “mospasjes masë disiplinore në fuqi”; dhe iv) “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Pas verifikimit të plotësisht të katër prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Komisioni, Komisioni vijoi me procesin për verifikimin e kritereve të pasurisë dhe figurës, paralelisht u vijua dhe me procesin e vlerësimit etik dhe profesional, procese që u zhvilluan nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Edhe në këtë rast, sikurse në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, faza e verifikimit u nda në dy pjesë, me qëllim për t'i hapur rrugë kryerjes së vlerësimeve etike dhe profesionale të kandidatëve, paralelisht me verifikimin e kriterëve të pasurisë dhe figurës së kandidatëve.

Për një kandidat të procedurës së shpallur në vitin 2021, që kishte kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, është administruar informacioni nga institucionet përkatëse dhe, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, është vendosur nga Këshilli kualifikimi i tij dhe vijimi i procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar sipas pozicionit përkatës ku kishte kandiduar.

Referuar proceduarve të mëhershme për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me propozim të Komisionit, Këshilli për vitin 2022 ka miratuar vendimin nr.15, datë 17.01.2022 për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 30, datë 25.01.2021, ndaj të cilit ishte përfunduar verifikimi i kushteve dhe kriterëve ligjore. Me propozim të Komisionit, Këshilli ka miratuar vendimin nr.141, datë 06.04.2022 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 117 dhe nr. 118, datë 01.04.2021”, si dhe caktimin e relatorit për secilën procedurë përzgjedhjeje për ngritje në detyrë.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, për kandidatët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, relatori i procedurës së përzgjedhjes, vijoi me propozimin për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 117, nr.118, nr. 119, datë 01.04.2021 si dhe për një pozicion të shpallur me vendimin nr. 30, datë 25.01.2021. Pas miratimit nga Këshilli të renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t'u ngritur në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar relatori i çështjes përcolli për miratim propozimin për ngritje në detyrë në Gjykatën e

Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për gjyqtarët z. {...}, z. {...} dhe znj. {...}.

Përfundime në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga ku rezulton se janë miratuar:

- 2 (dy) akte administrative kolektive, për përzgjedhjen për ngritjen në detyrë të kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

- 1 (një) akt administrativ individual, për kualifikimin e kandidatit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

- 4 (katër) akte administrative kolektive për renditjen e kandidateve në procedurën e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

- 3 (tre) akte administrative individuale, për ngritjen në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar:

Sipas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 286, datë 18.12.2019, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të kësaj gjykate është 16 (gjashtëmbëdhjetë), ashtu siç përcakton Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Përveç sa më sipër, vlen të theksohet se gjatë vitit 2021 me propozim të Komisionit, Këshilli ka hapur dhe rihapur procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për dymbëdhjetë pozicione të lira, për disa prej të cilave nuk u paraqit asnjë kandidaturë, ndërsa për pozicionin nr. 123, datë 01.04.2021, për pozicion e lirë nr. 125, datë 01.04.2021, për pozicion e lirë nr. 127, datë 01.04.2021 dhe për pozicionin e lirë nr. 128, datë 01.04.2021, Këshilli vijoi procedurën e ngritjes në detyrë për kandidatët që kandiduan.

Në vijim Komisioni ka hapur tre pozicione të reja të shpallura me vendimet nr. 499-501, datë 21.11.2022, duke përcaktuar dhe afatin dyjavor të kandidimit për këto procedura ngritje në detyrë. Për pozicionet e lira sa më sipër kandiduan 17

(shtatëmbëdhjetë) kandidatë. Vendimet janë ndarë sipas përcaktimeve përkatëse, në të cilat nuk po ndalem.

Për 2 (dy) kandidatë, një prej të cilëve është kandidat e procedurave të shpallura për vitin 2021, që kishin kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, është administruar informacioni nga institucionet përkatëse dhe, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, është vendosur nga Këshilli kualifikimi dhe vijimi i procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar sipas pozicionit përkatës ku kishte kandiduar. Për një kandidatë ende vijon procesi i verifikimit të figurës dhe pasurisë.

Referuar proceduarve të mëhershme për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me propozim të Komisionit, Këshilli ka miratuar vendimin nr.138, datë 06.04.2022 për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021. Me propozim të Komisionit, Këshilli ka miratuar vendimin nr.261, datë 15.07.2022 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 125, datë 01.04.2021”, si dhe caktimin e relatorit për secilën procedurë përzgjedhjeje për ngritje në detyrë.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, për kandidatët e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, relatori i procedurës së përzgjedhjes, vijoi me propozimin për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit, për pozicionin e lirë. Pas miratimit nga Këshilli të renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, relatori i çështjes përcolli për miratim propozimin për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për gjyqtaren znj. {...}.

Përfundime në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të

Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjatë vitit 2022, nga ku rezulton se janë miratuar:

- 3 (tre) akte administrative kolektive për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

- 2 (dy) akte administrative kolektive, për përzgjedhjen për ngritjen në detyrë të kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

- 2 (dy) akte administrative individuale, për kualifikimin e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

- 1 (një) akt administrativ kolektiv për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

- 1 (një) akt administrativ individual, për ngritjen në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

- 1 (një) akt mbi ndryshimin e pjesshëm të akteve.

Për gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatën administrative të apelit:

Në vijim, në zbatim të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe pas plotësimit të kuadrit të plotë ligjor për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, me propozim të KZHK-së, ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për 3 (tre) pozicione të lira. Konkretisht:

a) Vendimi nr. 502, datë 21.11.2022 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;

b) Vendimi nr. 503, datë 21.11.2022 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;

c) Vendimi nr. 504, datë 21.11.2022 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në

detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;

Afati i kandidimit për të gjitha këto pozicione të lira, ishte dy javë nga data e shpalljes së vendimit. Brenda afatit të kandidimit për këto pozicione të lira, kandiduan 25 (njëzet e pesë) kandidatë, për 3 (tre) nga pozicionet e lira.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, KZHK përgatit relacioni mbi projektvendimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatat e Apelit Tiranë, Durrës, dhe Korçë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.502, nr.503 dhe nr.503, datë 21.11.2022, dhe caktimin e shortit për relatorët për secilin kandidat.

Vlen të theksohet se KZHK-ja më herët kishte hapur procedurat e ngritjes në detyrë pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatës Administrative të Apelit, për 4 (katër) pozicione të lira, të shpallura me vendimet nr.129-130 datë 01.04.2021; me vendimet nr.290 datë 06.07.2021 dhe nr.571, datë 07.12.2021. Gjithashtu Komisioni ka propozuar disa herë rihapjen e tyre me qëllim plotësimin e vendeve vakante të përhershme pranë këtyre gjykatave duke miratuar 7 (shtatë) akte administrative kolektive për rihapjen e procedurave për ngritjen në detyrë pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm e më konkretisht me vendimet nr.18–20 datë 25.01.2021 dhe vendimet nr.132–135, datë 01.04.2021.

Ndërkohë, në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm/Gjykatën Administrative të Apelit, pati edhe tërheqje nga kandidimi nga disa kandidatë, e për rrjedhojë, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, Këshilli ka miratuar 11 (njëmbëdhjetë) vendime për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë të kandidatëve, në pozicionet respektive ku ata kishin kandiduar.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional, për kandidatët e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm/Gjykatën Administrative të Apelit, relatori i procedurës së përzgjedhjes, vijoi me propozimin për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit, për katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe një pozicion në fushën e të drejtës penale, në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallura me vendimet përkatëse, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile në

Gjykatën e Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale në Gjykatën e Apelit Korçë.

Pas miratimit nga Këshilli të renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t'u ngritur në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, Durrës, Korçë dhe Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale dhe civile, relatori i çështjes përcolli për miratim propozimin për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}; për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës z. {...} dhe për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, z. {...}, si dhe për ngritje në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, z. {...}.

Përfundime në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit gjatë vitit 2022, nga ku rezulton se janë miratuar:

- 3 (tre) akte administrative kolektive akte për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm;

- 1 (dy) akt administrativ kolektiv për fillimin e procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit;

- 5 (pesë) akte administrative individuale për kualifikimin e kandidatëve në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit;

- 11 (njëmbëdhjetë) akte administrative individuale për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për shkak të tërheqjes së kandidatit nga kandidimi në pozicionet përkatëse.

- 8 (tetë) akte administrative individuale nga të cilat 7 (shtatë) akte janë për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe 1 (një) akt për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit.

- 2 (dy) akte administrative kolektive për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit

- 8 (tetë) akte administrative individuale nga të cilat 7 (shtatë) akte janë për ngritje në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe 1 (një) akt për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit.

Pengesat e hasura:

- Kapërcimi i problematikave të hasura lidhur me procedurën e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, sa i përket kandidaturave nga radhët e gjyqtarëve në detyra të mëparshme si inspektorë dhe ish-inspektorë.

Mbi bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës:

Në respektim të detyrimeve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 29, të Ligjit për Statusin në janar të çdo viti, Këshilli duhet të përcaktojë dhe publikojë numrin maksimal të kandidatëve magjistratë (profili gjyqtar) që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik. Krahas kësaj, Këshilli duhet të përcaktojë dhe publikojë edhe numrin maksimal të kandidatëve këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik.

Nisur nga këto detyrime ligjore, Këshillit i duhej që, brenda janarit të vitit 2022, të përcaktonte numrin maksimal të kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar, të kandidatëve këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që duhet të pranoheshin në formimin fillestar, për vitin e ri akademik 2022–2023.

Mbi propozimin e Komisionit, Këshilli ka miratuar vendimin nr. 41, datë 31.01.2022 “Mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2022–2023”, në përmbajtjen e të cilit u përcaktua: (i) Numri i kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2022–2023, do të jetë 45 (dyzet e pesë); (ii) Numri i kandidatëve për ndihmës ligjorë, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2022–2023, është 10 (dhjetë) kandidatë ndihmës ligjorë.

Në kuadër të këtij procesi, është miratuar vendimi nr.87, datë 09.03.2022, i cili verifikoi plotësimin e kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatëve për ndihmës ligjorë.

Përfundime në lidhje me bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës, nga ku rezulton se është miratuar:

- 1 (një) akt administrativ kolektiv mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2022–2023.

Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës në kuadër të verifikimit të kandidatëve fitues për në formimin fillestar për magjistratë në Shkollën e Magjistraturës:

Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës ka ndërmarrë procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve fitues për në formimin fillestar për magjistratë, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2022–2023, sipas përcaktimeve ligjore, gjithsej për 45 (dyzet e pesë) kandidatë.

Menjëherë, mbi propozimin e KZHK-së, me vendimin nr. 197, datë 27.05.2022, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit për vitin akademik 2022–2023.

Megjithatë, procesi hasi në vështirësi për shkak se një pjesë e periudhës së verifikimit koincidoi me muajin gusht, gjatë të cilit subjektet publike dhe private funksionojnë me personel të reduktuar për shkak të kryerjes nga punonjësit të pushimeve vjetore, çka çoi në vonesa të dërgimit të informacioneve dhe raportimeve të kërkuara nga Këshilli, si dhe mos dërgimi i informacioneve dhe raportimeve nga Autoritetet Verifikues për kandidatët, si edhe nga Prokuroria e Përgjithshme.

Për rrjedhojë, Këshilli në mbledhjet e datës 03.11.2022, datës 07.11.2022, të datës 14.11.2022 si dhe të datës 06.12.2022, të datës 14.12.2022, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, ka kualifikuar 41 (dyzet e një) kandidatë për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar.

Tetë kandidatët e formimit fillestar për vitin akademik 2021–2022, procedura e të cilëve u zgjat në kohë në kuadër të verifikimit të figurës, u kualifikuan nga Këshilli në mbledhjen plenare të datës 07.06.2022, të datës 06/07.07.2022 dhe në mbledhjen plenare të datës 21.07.2022 dhe të datës 27.07.2022.

Vlen të theksojmë se janë ende në procedurë verifikimi dy kandidatë konkretisht për në formimin fillestar për vitin akademik 2021–2022, z. {...} dhe z. {...}.

Ndërkohë, për 4 (katër) kandidatë të formimit fillestar për vitin akademik 2022–2023, dhe për 2 (dy) kandidatë të formimit fillestar për vitin akademik 2021–2022, shqyrtimi i rezultateve të verifikimit nuk ka përfunduar, ndërsa është konsideruar i

domosdoshëm verifikimi i thelluar i të dhënave lidhur me kriterin e pasurisë/figurës, proces që po vijon në bashkëpunim me ILDKPKI-në dhe me subjekte të tjera.

Pra, deri në këtë moment, nga 56 (pesëdhjetë e gjashtë) kandidatë të vitit akademik 2021–2022 dhe 2022–2023, janë verifikuar dhe kualifikuar për në Shkollën e Magjistraturës 49 (dyzet e nëntë) kandidatë, është verifikuar dhe skualifikuar 1 (një) kandidat, ndërsa për 6 (gjashtë) kandidatë vijon ende verifikimi i thelluar i të dhënave në lidhje me kriterin e pasurisë dhe figurës.

Përfundime në lidhje me procedurat e verifikimit të kandidatëve, nga ku rezulton se:

- 49 (dyzet e nëntë) akte administrative individuale kualifikuese për kandidatët për magistratë nga të cilat 8 (tetë) janë kualifikuar kandidatë për magistratë, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2021–2022, si dhe 41 (dyzet e një) kandidatë për magistratë, profili gjyqtar, viti akademik 2022–2023;

- 1 (një) akt administrativ individual për skualifikimin e kandidatit për magistrat, profili gjyqtar, viti akademik 2021–2022;

- 1 (një) akt administrative kolektiv me anë të të cilit Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2022–2023.

- 1 (një) akt mbi ndryshimin e pjesshëm të akteve.

Pengesat e hasura:

- Një pjesë e periudhës së verifikimit përkoi me muajin gusht, gjatë të cilit subjektet publike dhe private funksionojnë me personel të reduktuar për shkak të kryerjes nga punonjësit të pushimeve vjetore, çka ka sjellë vonesa të dërgimit të informacioneve dhe raportimeve të kërkuara nga Këshilli;

- Nevoja për verifikime të mëtejshme për shkak të konstatimeve të hasura gjatë procedurës për verifikimin e kriterit të pasurisë dhe figurës.

- Mungesa e specialistit auditues financiar i cili do të mundësonte plotësimin në kohë me njohuri në fusha të specializuara në lidhje me kriterin e pasurisë.

Vijojmë me emërimin e magistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2021–2022:

Gjithçka është pasqyruar në akte dhe në përfundim, në lidhje me procedurat për emërimin e magistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magistraturës në vitin akademik 2021–2022, nga ku rezulton se janë miratuar:

- 2 (dy) akte administrative kolektive nga të cilat 1 (një) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit si gjyqtar, të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, dhe 1 (një) akt administrativ kolektiv për shpalljen e pozicioneve të lira për të diplomuarit nga Shkolla e Magistraturës, në vitin akademik 2019–2020;

- 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) akte administrative individuale, nga të cilat 23 (njëzet e tre) vendime për kualifikimin për emërim të kandidatëve të diplomuar, 23 (njëzet e tre) vendime për emërimin gjyqtar, si dhe 23 (njëzet e tre) vendime për caktimin në pozicion të gjyqtarëve të sapo emëruar.

- 2 (dy) akte administrative individuale për pezullimin/shfuqizimin e pezullimit të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve.

Mbi skemën e delegimit:

Pas bërjes funksionale të skemës së delegimit të gjyqtarëve, nga ku disa gjyqtarë të gjykatave të shkallës së parë, në përmbushje të përcaktimeve ligjore, me propozimet e KZHK-së, janë caktuar nga Këshilli në skemën e delegimit të ngritur pranë tij. Këta gjyqtarë, më pas, po me propozimet të KZHK-së, janë caktuar nga Këshilli për të gjykuar pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për shkak të vakancave të shumta pranë këtyre gjykatave dhe nevojës për të ruajtur funksionalitetin e tyre.

Kështu, në total për vitin 2022 janë caktuar 6 (gjashtë) gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm në skemë delegimi ngritur pranë Këshillit, të cilët më pas janë caktuar për të gjykuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, në Gjykatën e Apelit Durrës, në Gjykatën e Apelit Vlorë, në Gjykatën e Apelit Administrativ, si dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit.

Përfundime në lidhje me caktimin e gjyqtarëve, janë:

- 20 (njëzet) akte administrative individuale, nga të cilat 6 (gjashtë) vendime për caktimin e gjyqtarëve në skemën e delegimit, 4 (katër) vendime për zgjatjen e afatit të caktimit të gjyqtarëve të skemës së delegimit, 4 (katër) vendime për ricaktimin e gjyqtarëve të skemës së delegimit, 4 (katër) vendime për përfundimin para afatit të

shërbimit në skemën e delegimit, 1 (një) vendim për disa shtesa në përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, si dhe 1 (një) vendim për refuzim të pranimit në shërbimit në skemës së delegimit.

- 6 (gjashtë) akte administrative individuale për caktimin e gjyqtarëve të skemës së delegimit në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe gjykatat e posaçme.

Mbi komandimin e gjyqtarëve:

Përfundime në lidhje me gjyqtarët e komanduar përgjatë vitit 2022, nga ku rezulton se janë miratuar:

- 3 (tre) akte administrative kolektive për hapjen ose rihapjen/përfundimin e procedurave të komandimit të gjyqtarëve në Ministrinë e Drejtësisë, Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

- 9 (nëntë) akte administrative individuale në kuadër të procedurës së komandimit/përsëritjes së komandimit dhe përfundimit të kohëzgjatjes së saj, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë;

Mbi transferimin e gjyqtarëve:

Transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve sipas nenit 46 mbi statusin, arrihet në përfundimin që janë miratuar:

- 9 (nëntë) akte administrative kolektive për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm në gjykata;

- 10 (dhjetë) akte administrative individuale, prej të cilave 1 (një) akt për transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarëve, 8 (tetë) akte administrative individuale për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve në gjykata të ndryshme, 1 (një) akt për ndërprerjen e transferimit të përkohshëm.

Mbi mbarimin e statusit të magjistratit:

Përfundime në lidhje me dorëheqjet e paraqitura nga gjyqtarët përgjatë vitit 2022, nga ku rezulton se janë:

- 10 (dhjetë) akte administrative individuale për mbarimin e statusit të gjyqtarëve për shkak të paraqitjes së dorëheqjes;

- 1 (një) akt administrativ individual për përfundimin e procedurës së mbarimit të statusit të magjistratit.

Mbi caktimin në pozicion të gjyqtarëve:

Caktimi në pozicion i gjyqtarëve të ish-gjykatave për krimet e rënda

Në përfundim, në lidhje me gjyqtarët në detyrë pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, rezulton se janë miratuar:

- 2 (dy) akte administrative individuale për caktimin në pozicion në mënyrë të përhershme, të gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Mbi caktimin e gjyqtarëve në çështje të veçanta:

Gjatë vitit 2022, Komisioni ka trajtuar 566 kërkesa për caktim gjyqtari (kërkesa nga kryetarët respektivë të gjykatave), nga të cilat:

- 235 kërkesa të ardhura nga gjykatat e rretheve gjyqësore;
- 61 kërkesa të ardhura nga gjykatat administrative;
- 270 kërkesa të ardhura nga gjykatat e apeleve.

Në përgjigje të këtyre kërkesave, mbi propozimet e KZHK-së dhe pas procedurave të shortit elektronik, janë caktuar 742 (shtatëqind e dyzet e dy) gjyqtarë në gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, nga të cilët:

- 287 gjyqtarë nga gjykatat e rretheve gjyqësore;
- 77 nga gjykatat administrative (përfshirë edhe apelin administrativ); si dhe
- 378 nga gjykatat e apeleve (përfshirë edhe gjykatën e posaçme).

Në përfundim, rezulton se janë miratuar 74 (shtatëdhjetë e katër) akte administrative kolektive gjithsej, nga të cilat:

- 67 (gjashtëdhjetë e gjashtë) akte administrative nëpërmjet të cilave janë trajtuar 566 (pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) kërkesa për caktim gjyqtari dhe në përgjigje të tyre janë caktuar 742 (shtatëqind e dyzet e dy) gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme;

- 5 (pesë) akte mbi ndryshimin e pjesshëm të akteve;
- 2 (dy) akte lidhur me kërkesa të tjera të paraqitura pranë Komisionit.

Arrihet në përfundimin se gjatë vitit 2022, mbi projektvendimet e propozuara nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar gjithsej 377 vendime, nga të cilat:

□ 3 vendime në kuadër të procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur;

□ 97 vendime në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit;

□ 1 vendim në kuadër të procedurës së përcaktimit të numrit të kandidatëve për gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2022–2023;

□ 11 vendime në kuadër të procedurave të mbarimit të statusit të magjistratit;

□ 12 vendime në kuadër të procedurave të komandimit të gjyqtarëve;

□ 26 vendime në kuadër të procedurave të skemës së delegimit të ngritur pranë Këshillit;

□ 19 vendime në kuadër të procedurave të transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve;

□ 2 vendim në kuadër të procedurave të caktimit në pozicion të gjyqtarëve;

□ 73 vendime në kuadër të procedurave të emërimit të magjistratëve;

□ 52 vendime në kuadër të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kritereve të kandidimit për në formimin fillestar, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës;

□ 74 vendime në kuadër të procedurave të caktimit të gjyqtarëve në çështje gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme;

□ 7 vendime në kuadër të procedurave të tjera të lidhura me statusin dhe karrierën e gjyqtarëve.

Objektivat për vitin 2023:

1. Miratimi i akteve nënligjore

• Bazuar, në pikën 12, të nenit 52 të Ligjit për Statusin, KZHK-ja do të duhet të hartojë dhe propozojë rregulla më të detajuara, që lidhen me ngritjen në detyrën e kryetarit të gjykatës.

• Bazuar në pikën 9 të nenit 51 Ligjit për Statusin, KZHK-ja do të duhet të hartojë dhe propozojë rregulla të detajuara për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

2. Përfundimi i procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve për tre pozicione të lira të shpallura përgjatë vitit 2021, si edhe për një pozicion të lirë të shpallur përgjatë vitit 2022.

3. Përfundimi i procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit.

4. Hapja e procedurave të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të përcaktuara si gjykata në nevojë.

5. Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për caktimin e kuotave për magjistratë dhe ndihmës ligjorë për vitin akademik 2022–2023.

6. Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për verifikimin me prioritet të kandidaturave, të cilat mund të pranohen në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2023–2024 si dhe emërimin e magjistratëve që do të përfundojnë Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2022–2023.

7. Trajtimin në kohë të kërkesave të ardhura nga gjykatat, ku do të kërkohet caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të veçanta, në kushtet kur nëpër gjykata vijon krijimi i vakancave për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj gjyqtarëve.

8. Bashkëpunimi me institucionet e sistemit të drejtësisë nëpërmjet mekanizmit të komandimit të gjyqtarëve në funksion të mirëfunksionimit të këtyre institucioneve.

9. Trajtimin në kohë të kërkesave të ardhura nga gjyqtarët apo gjykatat e ndryshme që lidhen me çështje të karrierës gjyqësore.

Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Hallunaj lidhur me raportimin e veprimtarisë së Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Nëse nuk kemi ndonjë diskutim, kalojmë në miratimin e raportit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raportit mbi veprimtarinë e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për vitin 2022”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.02.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e raportit 3-vjeçar periodik për sistemin e vlerësimit dhe raport vjetor për veprimtari të tjera të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për vitin 2022”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 13:24.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Alban Toro*** (anëtar)
- 8. Marçela Shehu*** (anëtare)
- 9. Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Albana Boksi, Këshilltar për Etikën në gjykata.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e raportit 3-vjeçar periodik për sistemin e vlerësimit dhe raport vjetor për veprimtari të tjera të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për vitin 2022”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Kalojmë tek raportimi i Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit Kryetare!

Nga ana e Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale është përgatitur në një dokument të vetëm raportimi periodik për sistemin e vlerësimit sipas nenit 99, të ligjit “Për statusin”, i cili parashikon se: 1. Çdo 3 vjet, Këshillat publikojnë një raport periodik për sistemin e vlerësimit, në të cilin pasqyrohet të paktën ky informacion: a) përshkrim i përgjithshëm i vlerësimeve të kryera gjatë periudhës që mbulon ky raport; b) analiza e përfundimeve të vlerësimit, duke identifikuar dobësitë dhe

përparësitë e trupës së magistratëve dhe të sistemit gjyqësor ose prokurorisë; c) analiza e efikasitetit të rekomandimeve të miratuara në periudhën raportuese pararendëse; ç) rekomandimet për masat që duhen marrë për të kapërcyer dobësitë e identifikuara”.

Raporti periodik për sistemin e vlerësimit, përfshin periudhën 2019–2022, në kushtet kur plotësimi me akte nënligjore i Skemës së Vlerësimit filloi në vitin 2019, ndërsa zbatimi i saj deri në momentin e këtij raportimi është shtrirë në tre vite 2020–2022. Raporti periodik mbi zbatimin e sistemit të vlerësimit, për periudhën 2019–2022, ka pjesë përbërëse të tij edhe raportin e vlerësimit për vitin 2022, pa qenë e nevojshme hartimi i një raporti të veçantë për këtë vit, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit “Për statusin”.

Ndërkohë, pjesa e dytë e këtij raporti përbëhet nga raportimi i veprimtarisë tjetër të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, sipas parashikimeve të nenit 62, pika 16 e ligjit “Për organet e qeverisjes”.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (në vijim Komisioni) fokusohet në trajtimin e çështjeve të etikës dhe veprimtarisë profesionale të gjyqtarëve. Në një vështrim tërësor, por edhe të përmbledhur të punës së Komisionit për periudhën 3–vjeçare të raportimit lidhur me vlerësimet, duke përfshirë këtu edhe veprimtarinë e Komisionit për çështje të tjera përgjatë vitit 2022, rëndësi të veçantë i është kushtuar rregullave që plotësojnë Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve (akte nënligjore e rregulla të brendshme), nisjes së procesit të vlerësimit për të gjithë gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë, si dhe gradimit për gjyqtarët e konfirmuar me vendim të formës së prerë nga organet e rivlerësimit kalimtar.

Për sa i përket raportimit trevjeçar për sistemin e vlerësimit, ky raportim është ndarë në disa krerë, kreu i parë i të cilit fillon me veprimtarinë e komisionit për hartimin e akteve plotësuese të skemës së vlerësimit.

Për periudhën e raportimit 2019–2022, Komisioni është angazhuar në hartimin, diskutimin dhe paraqitjen për miratim pranë Këshillit të një sërë aktesh nënligjore e rregullave të brendshme për plotësimin e Skemës së Vlerësimit, e cila aktualisht është tërësisht e zbatueshme për gjyqtarët në detyrë dhe gjyqtarët e komanduar si ndihmësmagjistratë në Gjykatën e Lartë.

Në raport janë përmendur në mënyrë të detajuar aktet që plotësojnë skemën e vlerësimit për gjyqtarët në detyrë, të cilat janë 9 të tilla.

Referuar akteve që plotësojnë skemën e vlerësimit për ndihmësmagjistratët në Gjykatën e Lartë, janë miratuar, me propozim të Komisionit, në këtë periudhë trevjeçare raportimi, 5 akte të tilla.

Pjesa e dytë e raportit trevjeçar të vlerësimit përbëhet nga të dhënat dhe ecuria e programeve vjetore të vlerësimit etik dhe profesional, të miratuara nga Këshilli.

Në nenin 85/1 të ligjit “Për statusin” përcaktohet detyrimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor për miratimin e një programi vjetor vlerësimi, duke përcaktuar listën e magjistratëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi përgjatë vitit pasardhës dhe periudhën e vlerësimit. Për periudhën 3-vjeçare të raportimit, nga ana e Këshillit janë miratuar këto programe vlerësimi:

Programi i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve i miratuar për vitin 2020.

Në programin e vlerësimit për vitin 2020, u përfshinë në vlerësim, për periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 2017–2019, 106 (njëqind e gjashtë) gjyqtarë për vlerësim periodik, por përparësia u përcaktua për gradimet dhe vlerësimet e përsheptuara. Zbatimi i këtij programi gjatë vitit 2020 u bë i pamundur për vlerësimin periodik 3-vjeçar, për shkak të fillimit nga Këshilli me prioritet të vlerësimit të gjyqtarëve që kishin aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e posaçme, për të cilët bashkë me gradimin si vlerësim i pavarur, filloi procedura e vlerësimit të përsheptuar të detyruar për periudhën e vlerësimit, viti kalendarik 2019.

Konkretisht, për shkak të nevojës së diktuar nga plotësimi i vakancave në Gjykatën e Lartë, gjykatën e apelit dhe gjykatat e posaçme, Këshilli përgjatë vitit 2020 filloi: i) procedurën e vlerësimit me qëllim gradimi për 27 (njëzet e shtatë) gjyqtarë, kategori e cila përbënte prioritet në procedurat e vlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 171 të ligjit “Për statusin”, ii) procedurën e vlerësimit të përsheptuar të detyruar për vitin kalendarik 2019 për 42 (dyzet e dy) gjyqtarë të cilët kishin kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, kategori kjo që edhe përbënte prioritet në zbatim të akteve nënligjore të miratuara.

Fillimi i njëkohshëm i 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) procedurave të pavarura për periudha të ndryshme vlerësimi, në kushtet kur skema e vlerësimit zbatohet për herë të parë, solli rritje të volumit të punës për Komisionin, volum pune të cilit iu bashkëngjitën edhe vështirësitë e krijuara për shkak të situatës së pandemisë, si pasojë e përhapjes së virusit COVID-19, si dhe pezullimit të veprimtarisë së gjykatave, duke bërë të pamundur dërgimin në kohë të statistikave, zhvillimin e procedurave të shortit për përzgjedhjen e dosjeve për vlerësim, etj.

□ Programi i dytë i vlerësimit etik dhe profesional është ai i vitit 2021, por që është zbatuar në fakt në dy vite, në vitin 2021 dhe në vitin 2022.

Në programin e vlerësimit për vitin 2021, u rikonsideruan të gjithë gjyqtarët të cilët nuk ishin vlerësuar sipas programit të mëparshëm dhe u përfshinë si të tillë gjyqtarët me më pak se 15 vjet përvojë profesionale, numri i të cilëve ishte 52 (pesëdhjetë e dy) gjyqtarë. Ky program i miratuar për shkak të përparësive që diktoheshin nga procedurat për ngritje në detyrë, u zbatua në vitin 2021 dhe vitin 2022. Gjatë vitit 2021, Këshilli filloi procedurat e vlerësimit për 24 (njëzet e katër) gjyqtarë duke marrë parasysh rendin e përparësive, dhe në vijim, në vitin 2022 filloi procedurën për pjesën tjetër të mbetur të gjyqtarëve, 19 (nëntëmbëdhjetë) gjyqtarët e mbetur, pjesë e programit të vlerësimit.

Në total nga 52 (pesëdhjetë e dy) gjyqtarët pjesë e programit, procedura e vlerësimit periodik 3-vjeçar filloi për 43 (dyzet e tre) gjyqtarë, ndërsa për 9 (nëntë) gjyqtarë të miratuar në program, kjo procedurë nuk mund të fillonte, për shkak se 2 (dy) gjyqtarë e kishin humbur statusin e magistratit, 6 (gjashtë) të tjerë nuk e ushtronin funksionin për shkak të aplikimit të masës së “Shkarkimit nga detyra” nga organet e rivlerësimit, si dhe 1 (një) gjyqtar ishte vlerësuar me procedurë të përshpejtuar për efekt të ngritjes në detyrë, që ishte viti kalendarik 2019.

Në zbatim të nenit 85 të Ligjit “Për statusin”, është miratuar gjatë vitit 2022 programi i vlerësimit për vitin 2023, i ndërtuar në mënyrë të tillë që të sigurojë vlerësimin etik dhe profesional në kohë të gjyqtarit. Vlerësimi periodik i gjyqtarëve, kryhet 1 herë në 3 vjet për gjyqtarët me më pak se 15 vjet përvojë profesionale dhe 1 herë në 5 vjet për gjyqtarët që kanë përvojë profesionale mbi 15 vjet.

Në kushtet kur periudha e rivlerësimit kalimtar 2013–2016, për efekt të ligjit, konsiderohet periudhë vlerësimi për gjyqtarin që konfirmohet në detyrë, vlerësim që

përfundon me gradimin e gjyqtarit, fillimi i vitit të parë mbi të cilin llogariten periudhat e mëpasshme të vlerësimit 3 apo 5-vjeçare, është viti 2017 (pra fillojnë të llogariten nga 1 janari i vitit 2017). Në datën 31.12.2021, ishte plotësuar periudha e vlerësimit 5-vjeçare, por objektivisht ishte e pamundur fillimi i këtyre vlerësimeve, për shkak të:

i) numrit relativisht të lartë të procedurave të vlerësimit që vijonin ende, konkretisht 60 (gjashtëdhjetë) procedura vlerësimi;

ii) numrit të vogël të nëpunësve përgjegjës për vlerësimin të angazhuar në proceset e mesipërme të vlerësimit, 2 (dy) nëpunës përgjegjës;

iii) nevojës për kryerjen e vlerësimeve të përshpejtuara të detyruara për gjyqtarët që rishitazi aplikonin për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele, për të cilin sipas skemës së vlerësimit kishin përparësi;

iv) kryerjes në të njëjtën kohë me përparësi edhe të procedurave të vlerësimit me qëllim gradimi për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë, për të cilët do të përcilleshin në vijim nga organet e rivlerësimit aktet e vlerësimit profesional.

Programi i vlerësimeve për vitin 2023 përfshin përsëri një periudhë 3-vjeçare vlerësimi, që përkon me periudhën kalendarike 01.01.2020 – 31.12.2022, duke përfshirë në vlerësim gjyqtarët të cilët kishin plotësuar 3 (tre) vite përvojë profesionale në 31.12.2022, por që nuk kishin asnjë vlerësim etik dhe profesional, sipas skemës së re të vlerësimit. Për periudhën e vlerësimit 01.01.2020 – 31.12.2022, u përfshinë në program 9 (nëntë) gjyqtarë.

Në lidhje me gjyqtarët që do të vlerësohen dhe periudhën e vlerësimit, veç përfundimit të procedurave të vlerësimit të filluara më herët, programi i vlerësimit për vitin 2023, synon:

- a) Kryerjen me përparësi të të gjitha vlerësimeve me procedurë të përshpejtuar;
- b) Gradimin e gjyqtarëve;
- c) Vlerësimin 3-vjeçar për të gjithë gjyqtarët e përfshirë në programet e mëparshme e ato të përfshirë në programin e vitit 2023.

Në një kre të veçantë të këtij raportimi, mbi sistemin e vlerësimit 3-vjeçar është edhe evidentimi i ecures së procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve.

Gjatë periudhës 3-vjeçare të raportimit lidhur me vlerësimet, Këshilli nëpërmjet Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, është angazhuar në:

Kryerjen e gradimeve për periudhën e 3-vjeçare të vlerësimit 2013–2016, për gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar;

Kryerjen e vlerësimeve të përshpejtuara të detyruara për vitin e fundit kalendarik për gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë;

Kryerjen e vlerësimeve periodike 3-vjeçare, duke llogaritur fillimin e periudhës së vlerësimit mbi bazën kohës së punës së kryer nga gjyqtarët në detyrë (periudha e vlerësimit 2017–2019) e ata të komanduar në Gjykatën e Lartë (periudha e vlerësimit 2018–2020);

Njohjen e nivelit të vlerësimit të bërë në një rast nga institucioni ku gjyqtari kishte qenë i komanduar.

Lidhur me ecurinë e procedurave të gradimit, për të gjithë gjyqtarët për të cilët vendimi i organeve të rivlerësimit kalimtar ka marrë formë të prerë dhe janë përcjellë dosjet përkatëse pranë Këshillit, gjatë periudhës 3-vjeçare të raportimit, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimi), në total për 79 (shtatëdhjetë e nëntë) gjyqtarë. Konkretisht, duke i ndarë sipas viteve në të cilat kanë filluar këto procedura vlerësimi, rezulton si më poshtë:

27 procedura të filluar në vitin 2020;

24 procedura të filluara në vitin 2021;

28 procedura të filluara në vitin 2022;

Nga 79 (shtatëdhjetë e nëntë) gjyqtarë për të cilët ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional, Këshilli ka miratuar gjithsej 52 (pesëdhjetë e dy) raporte vlerësimi, duke përmbyllur procesin e vlerësimit etik-profesional për periudhën 2013–2016, për 52 (pesëdhjetë e dy) gjyqtarë.

36 raporte janë miratuar në vitin 2021;

16 raporte janë miratuar në vitin 2022;

Për 3 (tre) gjyqtarë të tjerë është deklaruar përfundimi i procedurës pa vendim përfundimtar, për shkak se objekti i saj ka qenë i pamundur, ndërkohë që kanë qenë ende pa u shqyrtuar në mbledhje plenare deri në 31.12.2022, 5 (pesë) projektraporte vlerësimi të përfunduara nga Komisioni, që i përkasin periudhës së gradimit. Procedurat e vlerësimit me qëllim gradimi vazhdojnë për 19 (nëntëmbëdhjetë) gjyqtarë, nga të cilat për

1 (një) gjyqtar procedura e filluar më herët është pezulluar deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Të dhënat mbi ecurinë e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional janë pasqyruar në grafik në raport, nga i cili rezulton se janë miratuar rreth 66% të vlerësimeve të filluara; janë në pritje për t'u shqyrtuar nga mbledhja plenare 6% e tyre; kanë përfunduar pa një vendim përfundimtar 4% e vlerësimeve të filluara dhe janë ende në proces 24%, nga të cilat 1% janë procedura të pezulluara dhe 23% procedura që vijojnë pranë relatorëve përkatës.

Lidhur me ecurinë e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar, gjatë periudhës 3-vjeçare janë filluar procedurat e vlerësimit për 55 (pesëdhjetë e pesë) gjyqtarë për vitin e fundit kalendarik, të ndara si më poshtë:

- 42 procedura të filluar në vitin 2020;
- 4 procedura të filluara në vitin 2021;
- 9 procedura të filluara në vitin 2022;

Këshilli ka miratuar gjithsej 42 (dyzet e dy) raporte vlerësimi të përshpejtuar të detyruar, duke plotësuar me nga 2 vlerësime 42 (dyzet e dy) gjyqtarë që kanë aplikuar për ngritje në detyrë.

- 36 raporte vlerësimi janë miratuar në vitin 2021;
- 6 raporte vlerësimi janë miratuar në vitin 2022;

Për 5 (pesë) gjyqtarë të tjerë është deklaruar përfundimi i procedurës pa vendim përfundimtar, për shkak të rënies së shkakut për të cilin kjo procedurë kishte filluar, ndërkohë që deri në datën 31.12.2022 ka qenë ende pa u shqyrtuar në mbledhje plenare 1 (një) projektraport vlerësimi i përfunduar nga Komisioni. Lidhur me këtë vlerësim vazhdojnë procedurat e për 7 (shtatë) gjyqtarë të tjerë, vlerësime të filluara në fund të vitit 2022.

Edhe ecuria e procedurave të vlerësimit të përshpejtuar evidentohet në grafik në raport dhe sikundër konstatohet, rezulton se janë miratuar 76% e totalit të vlerësimeve të filluara; janë në pritje për t'u shqyrtuar nga mbledhja plenare 2% e tyre; kanë përfunduar pa një vendim përfundimtar 13% e vlerësimeve të filluara dhe janë ende në proces vetëm 9% e tyre.

Lidhur me periudhën e vlerësimit 2017–2019, sikundër relatova edhe më sipër, programi i vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2021 është zhvilluar në dy faza. Konkretisht, për 24 gjyqtarë është filluar vlerësimi në vitin 2021 dhe për 19 gjyqtarë në vitin 2022;

Nga 43 (dyzet e tre) procedura vlerësimi 3-vjeçare që i përkasin periudhës së vlerësimit 2017–2019, procedura të filluara këto, Këshilli ka miratuar 4 (katër) raporte vlerësimi, 5 (pesë) projektraporte të tjera i janë përcjellë mbledhjes plenare dhe janë në pritje për shqyrtim, ndërsa për 1 (një) gjyqtar procedura e filluar është e pezulluar për shkak të anëtarësisë së mëvonshme në KLGJ, ndërkohë që për 2 (dy) gjyqtarë të tjerë këto procedura nuk mund të vazhdonin për shkak të humbjes së statusit të magjistratit. Procedurat e vlerësimit 3-vjeçare vazhdojnë për periudhën e vlerësimit 2017–2019 për 31 (tridhjetë e një) gjyqtarë.

Edhe për këto procedura ecuria është e pasqyruar në projektraport. Për këto procedura mund të themi që jemi në vonesë për shkak të formimit me vonesë të dosjeve të vlerësimit pasi rezultojnë që nga tërësia e procedurave të filluara, rreth 72% e tyre janë të papërfunduara.

Në kohëzgjatjen e 31 (tridhjetë e një) procedurave 3-vjeçare vlerësimi të papërfunduara ende, veç burimeve të kufizuara njerëzore të nëpunësve përgjegjës për vlerësimin të përgjithshëm në këtë proces, kanë ndikuar një sërë faktorësh si: i) angazhimi i Komisionit për kryerjen e vlerësimeve të konsideruara prioritare (gradim dhe i përshtetshëm); ii) plotësimi me vonesë i dosjeve të vlerësimit, për sa i përket dërgimit nga gjykatat të të dhënave të sakta statistikore; iii) pritja e rezultateve të trajtimit të ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarëve gjatë periudhës së vlerësimit, etj. Në kushtet kur sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve nuk gjeneron të dhëna statistikore, këto të fundit plotësohen manualisht nga stafi administrativ i gjykatave. Në jo pak raste statistikave i kthehen stafit administrativ të gjykatave për plotësim të saktë të dhënash, e metë që nuk është tejkalluar ende, pavarësisht trajnimeve të zhvilluara nga Këshilli lidhur me këtë çështje. Nga ana tjetër, ngarkesa e Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional në Këshill me përgatitjen në të njëjtën kohë të raporteve ndihmëse për organet e rivlerësimit dhe raporteve analitike për qëllim të sistemit të vlerësimit, e shoqëruar me burime njerëzore të pakta të nëpunësve me statusin e gjyqtarit të ngarkuar për të bërë këto raporte, ka ndikuar

në kohëzgjatjen e tyre. Trajtimi i ankesave të bëra ndaj gjyqtarëve kërkon gjithashtu kohë dhe angazhim nga ILD-ja, çka ndikon në kohëzgjatjen e procedurave të vlerësimit, pasi rezultatet e trajtimit të këtyre ankesave përbëjnë sipas ligjit burime vlerësimi.

Gjatë periudhës trevjeçare, Këshilli është angazhuar edhe nëpërmjet Komisionit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, edhe për ndihmësmagjistratët në Gjykatën e Lartë. Është përgatitur në këtë rast, në bazë të kërkesës së ushtruar nga zëvendëskryetari në detyrë për konfirmimin e ndihmësmagjistratit dhe zgjatjen e afatit të komandimit, një vlerësim etik dhe profesional trevjeçar i vitit 2018–2020, për të cilin mund të themi që Komisioni ka përgatitur projektraportin e vlerësimit brenda afateve të parashikuara në aktet nënligjore.

Lidhur me ecurinë e procedurave të vlerësimit, në një rast kanë filluar dhe kanë përfunduar dhe procedurat për njohjen e nivelit të vlerësimit për një gjyqtar, gjatë kohës që ai ka ushtruar detyrën e pedagogut të brendshëm të Shkollës së Magjistraturës, për periudhën e vlerësimit 2019–2021, vlerësim ky i kryer nga Shkolla e Magjistraturës, por i njohur si nivel vlerësimi nga ana e Këshillit.

Në tërësi, për sa i përket raporteve të vlerësimit të miratuara nga Këshilli për periudhën trevjeçare të raportimit, rezulton se janë miratuar në plenare 99 (nëntëdhjetë e nëntë) raporte vlerësimi, duke plotësuar me nga 2 (dy) vlerësime 45 (dyzet e pesë) gjyqtarë dhe me nga 1 (një) vlerësim 9 (nëntë) gjyqtarë. Ndërkohë që janë mbyllur pa vendim përfundimtar për shkak se qëllimi apo objekti ka qenë i pamundur 10 (dhjetë) procedura vlerësimi. Të dhënat janë pasqyruar në një grafik, nga i cili rezulton se për të gjithë periudhën 3-vjeçare të vlerësimit, në raport me vlerësimet e filluara (gradime, vlerësime të përshpejtuara dhe vlerësime trevjeçare) rezulton që të kenë përfunduar me miratim të raportit të vlerësimit 55% e vlerësimeve të filluara; janë në pritje për tu shqyrtuar nga mbledhja plenare 6% e tyre; kanë përfunduar pa një vendim përfundimtar 6% e vlerësimeve të filluara dhe janë ende në proces vlerësimi 33% e tyre, nga të cilat për 32% e procedurave të vlerësimit vazhdojnë, ndërsa për 1% procedurat e vlerësimit janë pezulluar.

Lidhur me kërkesën e parashikuar në ligj për evidentimin në raportin trevjeçar të sistemit të vlerësimit të rezultateve të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve.

Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit ka për qëllim vlerësimin e shkallës së aftësisë së gjyqtarit në drejtim të etikës dhe veprimtarisë së tij profesionale. Kjo shkallë aftësie ndiqet nga një pikëzim, mbi të cilin përcaktohet niveli i vlerësimit për çdonjërin nga katër kriteret e vlerësimit, si dhe ai i përgjithshëm. Referuar raporteve të vlerësimit të miratuara nga Këshilli evidentohet se:

□ Në procedurat e vlerësimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimi), për 45 (dyzet e pesë) gjyqtarë, Këshilli ka miratuar nivelin “Shkëlqyeshëm” (pra raportet janë miratuar në nivelin “Shkëlqyeshëm” për 45 gjyqtarë) dhe vetëm për 7 (shtatë) gjyqtarë është miratuar niveli i vlerësimit “Shumë mirë”.

□ Në procedurat e vlerësimit të përsheptuara të detyruara, janë miratuar për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit “Shkëlqyeshëm” 33 (tridhjetë e tre) gjyqtarë dhe për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit “Shumë mirë” 9 (nëntë) gjyqtarë;

□ Në procedurat e vlerësimit për periudhën e vlerësimit 2017–2019, janë miratuar për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit “Shkëlqyeshëm” 4 (katër) gjyqtarë;

□ Në procedurën për njohjen e nivelit të vlerësimit të bërë nga institucioni ku gjyqtari ka qenë i komanduar, është miratuar konvertimi/njohja për nivelin e vlerësimit “Shkëlqyeshëm”. Rezultate këto të paraqitura edhe në grafik.

Nga 99 vlerësime, raporte vlerësimi të miratuara nga Këshilli, rreth 84% e tyre janë në nivelin e vlerësimit “Shkëlqyeshëm” dhe 16% e tyre janë në nivelin “Shumë mirë”. Ndërkohë që asnjë gjyqtar nuk është vlerësuar me një nivel më të ulët vlerësimi, tregues ky i një niveli shumë të lartë profesional të gjyqtarëve të vlerësuar deri tani.

Skema e vlerësimit gjatë zbatimit të saj, për gjyqtarët në detyrë, ka qenë funksionale, pa krijuar problematika në drejtim të aplikimit të dispozitave ligjore. Procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të zhvilluara kanë dhënë rezultate konkrete në zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve duke bazuar promovimin e tyre mbi bazë të meritave profesionale. Zbatimi i skemës prodhon vlerësime që synojnë objektivitetin dhe transparencën. Raportet e vlerësimit janë gjithëpërfshirës, të argumentuar e detajuar për çdo element të punës së gjyqtarit. Aplikimi i skemës në vlerësimet individuale arrin të evidentojë problematikat e shfaqura në punën e çdo gjyqtari dhe i shërben orientimit të drejtë të nevojave të tij, jo vetëm për trajnimin vazhdues, por edhe për përmirësimin e punës së gjyqtarit.

Pavarësisht problematikave të hasura gjatë procedurave të vlerësimit, të cilat ndikojnë kryesisht në kohëzgjatjen e procedurës, aplikimi i skemës së re të vlerësimit të gjyqtarëve gjatë kësaj periudhe mund të thuhet se ka rezultuar produktiv, efektiv dhe me një vëmendje të posaçme në aspektin cilësor të procesit të vlerësimit.

Lidhur me rekomandimet që kërkohen nga ligji për t'u evidentuar në raport, rekomandime këto të dhëna ndaj gjyqtarëve për të përmirësuar veprimtarinë e gjyqtarit, mund të themi se rekomandimet që Këshilli ka bërë në raportet e vlerësimit të gjyqtarëve i shërbejnë qëllimit të vlerësimit të gjyqtarit. Vlerësimi nuk ka për qëllim të ndëshkojë gjyqtarin, por ta nxitë atë në drejtim të rritjes profesionale, përmirësimit të cilësisë së punës e aftësive menaxheriale, respektimit të etikës dhe rritjes së angazhimit profesional.

Në të gjitha rekomandimet e dhëna gjyqtarëve, është kushtuar rëndësi e veçantë nxitjes së gjyqtarëve për të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues, me qëllim jo vetëm shkëmbimin e njohurive e unifikimin e qëndrimeve në çështje të njëjta, por edhe për përmirësimin e vazhdueshëm të etikës e aftësisë së tyre profesionale.

Një nga objektivat e vlerësimit të veprimtarisë profesionale është edhe identifikimi i nevojave për trajnim të gjyqtarit. Me qëllim ngritjen e tyre profesionale, gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtari duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij, të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli, rekomandime këto të bëra pothuajse në të gjitha raportet e vlerësimit për të gjithë gjyqtarët, pavarësisht nivelit të tyre të vlerësimit.

Në disa raste gjyqtarëve iu është rekomanduar që, pavarësisht ngarkesës së çështjeve, të organizojnë punën dhe menaxhojnë kohën, duke i dhënë prioritet shqyrtimit të çështjeve me afat ligjor.

Megjithëse përgjegjësitë e gjyqtarit ndryshojnë midis juridiksioneve dhe roleve specifike, gjyqtari në çdo nivel dhe në çdo detyrë duhet të ketë aftësi të mira organizative në mënyrë që të jetë produktiv. Gjyqtari nuk mund të jetë produktiv pa pasur aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij/saj, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe kur gjykon në panel me të tjerë. Në këtë aspekt është

rekomanduar që gjyqtarët të bëjnë përpjekje maksimale në menaxhimin efektiv të kohës, si në planifikimin e seancave gjyqësore, ashtu edhe në veprimet procedurale jashtë tyre, pa krijuar pengesa në ecurinë e gjykimit të çështjeve në kolegje.

Pjesa e fundit e raportimit trevjeçar të sistemit të vlerësimit i kushtohet rekomandimeve për masat që duhen marrë për të kapërcyer dobësitë e identifikuara.

Gjatë eksperiencës 3-vjeçare të aplikimit të skemës së vlerësimit të gjyqtarëve, në procedurat individuale të vlerësimit të zhvilluara nga Këshilli, janë evidentuar disa vështirësi me karakter organizativ dhe procedural, që vijnë kryesisht për shkak të volumit të madh të dosjeve dhe zhvillimit njëkohësisht të disa procedurave vlerësimi. Pavarësisht se Këshilli filloi funksionimin e tij në dhjetor të vitit 2018, procedurat e vlerësimit nuk mund të fillonin më parë se viti 2020, për shkak se vlerësimi i parë periodik i mundshëm ishte ai 3-vjeçar 2017–2019. Kjo solli që duke filluar nga viti 2020 Këshilli të angazhohej veç vlerësimit periodik, në vlerësimet me qëllim gradimi e ato të përshpejtuara, për një numër gjithmonë e në rritje gjyqtarësh, por me një numër në ulje të vlerësuesve, nëpunësve përgjegjës për vlerësimin me statusin e gjyqtarit dhe me një përvojë pune që i përgjigjej rëndësisë që ka vlerësimi.

Lidhur me dobësitë dhe masat për kapërcimin e tyre:

Është konstatuar vështirësi në plotësimin në kohë të tabelave me të dhëna statistikore të nevojshme në procesin e vlerësimit, për shkak se një pjesë e tyre përpunohen ende në mënyrë manuale nga punonjësit e gjykatave, duke shkaktuar në disa raste vonesa ose pasaktësi në plotësim, për të cilat ka lindur nevoja e korrigjimit të të dhënave të dërguara në Këshill. Në këtë aspekt, edhe pse në bashkëpunim me projektin e Këshillit të Evropës që asiston Këshillin, janë zhvilluar disa trajnime rajonale me nëpunësit gjyqësorë civilë, problematika nuk është evituar. Prandaj rekomandohet që përmirësimet e vazhdueshme të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve dhe angazhimi i dedikuar i një punonjësi në çdo gjykatë për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore, deri në momentin kur ato do të gjenerohen nga sistemi, mund të ndikojë në përmirësimin e situatës;

Së dyti, është konstatuar se mendimi i kryetarit si burim vlerësimi në shumicën e rasteve nuk përmban analizë të të dhënave dhe përgjithësisht mungojnë elementët krahasimorë për treguesit e performancës, në raport me treguesin mesatar të gjykatës

përkatëse. Në disa raste kryetarët marrin rolin e vlerësuesit, e në disa raste të tjera thjesht konfirmojnë vetëvlerësimin e gjyqtarit. Tendenca ka treguar se ky burim vlerësimi nuk jep të dhëna objektive dhe të dobishme për vlerësimin. Trajnimi i kryetarëve apo zëvendëskryetarëve në detyrë të gjykatave duhet të vijojë, megjithatë për shkak të marrëdhënieve që krijohen brenda trupës gjyqësore, duket që objektiviteti në mendimin e kryetarit si burim vlerësimi është i ndikueshëm;

Së treti, kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit ndikohet ndjeshëm në fazën e krijimit të dosjes së vlerësimit nga koha e nevojshme për administrimin e dokumenteve nga institucione të tjera, koha e nevojshme për dërgimin e dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short për vlerësim nga gjykatat, si dhe burimet njerëzore të kufizuara sa i përket aktorëve që zhvillojnë procesin e vlerësimit. Në një të ardhme dosja elektronike do të sillte përshpejtim të procedurave;

Pamundësia objektive për miratimin e kriterëve të reja matëse të punës së gjyqtarit në aspektin sasior dhe cilësor për shkak se për këtë qëllim nevojitet një studim jo vetëm i shtrirë në kohë, por edhe i zhvilluar në një kohë kur gjykatat do të funksiononin me kapacitet të plotë dhe në kushte normale ngarkese, është gjithashtu e evidentueshme. Kjo pamundësi ka sjellë si pasojë aplikimin e standardeve ekzistuese të miratuara në vitin 2010 nga ish-KLD-ja. Këto standarde të miratuara para 10 vitesh, sjellin shpesh herë nevojën e një analize më të zgjeruar të faktorëve që ndikojnë në pikëzimin e treguesve të aftësive organizative të gjyqtarit, duke qenë se me ndryshimet që kanë pësuar ligjet procedurale në vitet e fundit, si dhe ngarkesën përgjithësisht tepër të lartë të gjykatave, kriteret matëse të aftësive organizative të gjyqtarit nuk janë plotësisht koherente me situatën aktuale. Prandaj rekomandohet që pas zbatimit të hartës së re gjyqësore, me përqendrimin e gjykatave në gjykata më të mëdha, me gjyqtarë të specializuar në seksione, të miratohen standardet e reja matëse në drejtim të efijencës së drejtësisë;

Gjithashtu, një rekomandim është edhe ai i zgjerimit dhe i plotësimit të Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional.

Kjo ishte pak a shumë për sa i përket raportimit për gjendjen trevjeçare të sistemit të vlerësimit.

Lidhur me raportimin për veprimtaritë e tjera të Komisionit për vitin 2022.

Gjatë vitit 2022, veç angazhimit të Komisionit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, ky Komision është angazhuar edhe në trajtimin e kërkesave të gjyqtarëve në fushën e veprimtarisë së Komisionit dhe paraqitjen e tyre pranë Këshillit; Në administrimin e kërkesave të gjyqtarëve për ushtrimin e veprimtarive jashtë funksionit; Në trajtimin e vazhdueshëm të dokumentacionit dhe praktikave të kaluara pranë Komisionit; Përgjatë vitit 2022 ka zhvilluar në total 25 mbledhje të cilat janë materializuar në 69 vendimmarrje.

Konkretisht, Komisioni ka trajtuar kërkesat e gjyqtarëve në lidhje me lejet e papaguara duke trajtuar dhe përgatitur për plenare 4 (katër) projektvendime; Përgjatë vitit nga procedurat e shortit, duke trajtuar dhe përgatitur për plenare 1 (një) projektvendim; Si dhe ka trajtuar një kërkesë për anulimin e vendimit të zëvendëskryetarit për zbritjen e ditëve të punës së gjyqtarit me lejen vjetore të pakryer, duke përgatitur për plenare 1 (një) projektvendim.

Në të njëjtën kohë, Komisioni ka administruar edhe çdo kërkesë apo njoftim të gjyqtarit lidhur me veprimtaritë jashtë funksionit sipas pikës 4, të nenit 9 të ligjit “Për statusin”. Në referim të këtij parashikimi, përgjatë vitit 2022 janë paraqitur në Këshill 35 (tridhjetë e pesë) kërkesa për dhënie miratimi apo njoftim për përfshirjen në veprimtari jashtë funksionit, të cilat kanë qenë kryesisht për veprimtari në fushën akademike të mësimdhënies.

Këto kërkesa janë trajtuar nga Komisioni, i cili pasi ka zhvilluar procedurën administrative, ka përgatitur për plenare 3 (tre) projektvendime të miratuara. Ndërkohë që lidhur me kërkesat e tjera, ato janë konsideruar të aprovuara në heshtje, për shkak të mos shprehjes me vendim brenda afati 3-javor nga marrja e kërkesës.

Kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit të gjyqtarëve, janë evidentuar në regjistrin elektronik të administruar nga Komisioni dhe në përfundim të vitit kalendarik për ato është hartuar raporti i arsyetuar lidhur me veprimtaritë jashtë funksionit, në bazën e të dhënave specifike të dërguara nga çdo gjyqtar për natyrën e kësaj veprimtarie, kohëzgjatjen e saj, institucionin ku është ushtruar aktiviteti dhe masën e shpërblimit të përfituar përgjatë vitit 2022 për kryerjen e këtyre veprimtarive.

Lidhur me angazhimin e Komisionit në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, Komisioni është angazhuar në:

Caktimin dhe përditësimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës, për mentorim për kandidatët e vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës, duke caktuar 45 (dyzet e pesë) gjyqtarë, trupë gjyqësore e përditësuar kjo me 55 (pesëdhjete e pesë) gjyqtarë në vitin 2022;

Është angazhuar në përcaktimin e gjykatave që do të shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magjistratë, profili gjyqtar, gjatë vitit akademik 2022-2023, si dhe gjyqtarët udhëheqës për mentorimin e 40 (dyzet) kandidatët për magjistratë;

Nevojën e përditësimit të trupës së gjyqtarëve udhëheqës të caktuar për kandidatët për magjistratë, duke ndryshuar pjesërisht mentorët për shkak të zbatimit të masave disiplinore nga ana e organeve të rivlerësimit.

Në kuadër të bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës, Komisioni është angazhuar edhe në procesin e miratimit të programit të trajnimit vazhdues, duke propozuar tema konkrete për trajnim, në përputhje me nevojat që kanë rezultuar nga ecuria e vlerësimit etik dhe profesional, në përputhje me nenin 68 shkronja “ç” të ligjit “Për statusin”.

Komisioni ka trajtuar çdo kërkesë të paraqitur nga gjykatat dhe gjyqtarët, që kanë të bëjë me fushën e veprimtarisë së tij, duke adresuar këtë çështje pranë Këshillit për trajtim, ose sipas rastit me përgatitjen e opinionëve ose kthimin e përgjigjeve përkatëse. Në këtë kuadër janë administruar të gjitha njoftimet të dërguara nga gjyqtarët, lidhur me pjesëmarrjen e tyre në seminare, trajnime, konferenca rajonale apo aktivitete të tjera të organizuara nga organizata të ndryshme kombëtare apo ndërkombëtare, të cilat janë evidentuar në një regjistër elektronik të administruar nga Komisioni;

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, Komisioni ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me këshilltarin për etikën me qëllim hartimin e manualit të kodit të etikës, draftimi i të cilit nuk ka përfunduar ende.

Në përfundim të këtij raportimi, të vetëdijshëm për sfidat e KLGJ-së si organ qeverisës në përmbushje të detyrimit për një drejtësi cilësore dhe efikasitet, që nxit meritokracinë dhe profesionalizmin, Komisioni angazhohet të vazhdojë punën me përgjegjësi e përkushtim, me qëllim:

1. Përfundimin e rregullave të detajuara për ushtrimin e veprimtarive jashtë funksionit;
2. Përfundimin e akteve plotësuese të Skemës së Vlerësimit Etik dhe Profesional për gjyqtarët e komanduar në KLGJ, ish-inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
3. Vazhdimin e vlerësimit me prioritet të gjyqtarëve që aplikojnë për ngritje në detyrë;
4. Vazhdimin me prioritet të procedurave të vlerësimit me qëllim gradimi për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë;
5. Përfundimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për të gjithë gjyqtarët e përfshirë në programet periodike të vlerësimit të gjyqtarëve;
6. Vijimin e punës për hartimin e udhëzuesi për një rol aktiv të gjyqtarëve në menaxhimin e çështjeve gjyqësore e monitorimin e shtyrjes së seancave gjyqësore, me qëllim përmbushjen e rregullave të brendshme të gjykatave, lidhur me efikasitetin e drejtësisë;
7. Vijimin e bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës në lidhje me nevojat për trajnimin e gjyqtarëve, përditësimin e listës së magjistratëve udhëheqës me qëllim rritjen e efektivitetit të procesit të mentorimit për kandidatët gjyqtarë;
8. Vazhdimin e bashkëpunimit me të gjitha komisionet e tjera në Këshill, për plotësimin e kuadrit nënligjor të nevojshëm, si brenda edhe jashtë fushës së veprimtarisë së Komisionit.

Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ftoj kolegët, nëse nuk kanë diskutime, të miratojmë projektraportin.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raportit 3-vjeçar periodik për sistemin e vlerësimit dhe raport vjetor për veprimtari të tjera të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për vitin 2022” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.02.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e raportit mbi veprimtarinë e Komisionit Disiplinor, për vitin 2022”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 13:24.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
7. **Albana Boksi, Këshilltar për Etikën në gjykata.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e raportit mbi veprimtarinë e Komisionit Disiplinor, për vitin 2022”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore znj. Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Kalojmë tek raporti i radhës që ka të bëjë me veprimtarinë e Komisionit Disiplinor përgjatë vitit 2022. Për më shumë detaje, fjalën ia jap kryetares së këtij komisioni, znj. Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit Kryetare!

Përgjatë vitit 2022, vizioni i Komisionit Disiplinor gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij është udhëhequr nga përgjegjshmëria dhe zbatueshmëria në praktikë e kuadrit ligjor për procedurat disiplinore, duke synuar realizimin e objektivave të vendosura nga vetë Komisioni në vitin paraardhës dhe që lidhen me: (i) aplikimin e praktikave më të mira dhe standardeve të vendosura kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me procedimet disiplinore të filluara ndaj gjyqtarëve; (ii) respektimin e pavarësisë së gjyqtarëve në ushtrimin e funksioneve gjyqësore; (iii) garantimin e seancave dëgjimore publike në zbatim të parimit të një procesi të rregullt ligjor dhe parimit të drejtësisë së hapur; (iv)

garantimin e barazisë së armëve, duke respektuar në nivelin më të lartë të mundshëm të drejtat procedurale të subjekteve të procedimit, dhe në veçanti ato të parashikuara në ligj për magistratin; (v) garantimin e pavarësisë dhe paanësisë së institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, jo vetëm në të qenit por dhe të dukjes si i tillë; (vi) përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues, duke marrë mendime dhe sugjerime nga të gjithë grupet e interesit, qoftë me anë të takimeve apo gjatë trajnimeve të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës për procedimet disiplinore.

Nën dritën e këtyre objektivave si dhe referuar përcaktimeve ligjore dhe kushtetuese të neneve 147, pika 1, 147/a, pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit gjyqësor”, të ndryshuar, roli i Komisioni Disiplinor, mbetet i drejtuar në rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së gjyqtarëve, në aspektin e përgjegjësisë disiplinore, për shkeljet disiplinore që lidhen me ushtrimin e funksionit si dhe jashtë tij.

Në lidhje me procedurat disiplinore:

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë në kompetencë të tij, Komisioni Disiplinor ka kaluar për shqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor 4 (katër) procedura disiplinore. Në vijim të procedurave, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i është dhënë fund, me vendim përfundimtar 3 (tre) procedurave disiplinore, nga të cilat 1 (një) procedurë me objekt pezullimin e një magjistrati nga detyra dhe 2 (dy) procedime disiplinore, të filluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Konkretisht:

Me vendimin nr.6, datë 17.01.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur miratimi i marrëveshjes së përbashkët të pranimit, e dakordësuar midis Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistrates {...}, për veprime të kryera jashtë ushtrimit të detyrës, të konsideruara si sjellje që diskreditonin pozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmtonin besimin e publikut në sistemin gjyqësor, të parashikuara si shkelje disiplinore në nenin 103, shkronja “dh” e ligjit “Për statusin”, si dhe nga Seksioni “C”, shkronja “a” dhe “b” dhe Seksioni “Ç”, pika 9, shkronja “c” e Kodit të Etikës Gjyqësore. Bazuar në marrëveshjen e përbashkët të pranimit të shkeljes disiplinore, Këshilli i Lartë Gjyqësor me miratimin e marrëveshjes, ka vendosur caktimin e masës disiplinore të “Pezullimit nga detyra me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë kohore për 6 muaj”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “d”, dhe neni 110 i Ligjit për Statusin,

si masë e dakordësuar midis palëve dhe e vlerësuar nga Këshilli si në përputhje me ligjin dhe në zbatim të përshtatshëm dhe të balancuar të parimeve të drejtësisë, objektivitetit, individualizmit dhe proporcionalitetit.

Në përfundim të këtij procedimi disiplinor, Këshilli nëpërmjet disponimit për rastin konkret, gjithashtu, ka vendosur disa standarde mbi identifikimin e natyrës së veprimeve të kryera jashtë ushtrimit të funksionit, që mund të kategorizohen nga institucionet disiplinore si sjellje që rrezikojnë pavarësinë, integritetin dhe paanshmërinë e një gjyqtari, të minojnë besimin e publikut në gjyqësor dhe/ose të çojnë në vendosjen e masave disiplinore ndaj një gjyqtari.

Me vendimin nr.267, datë 19.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe vendosja e masës disiplinore të pezullimit nga detyra, me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë 3 (tre) mujore, për magjistratin T.T., bazuar në nenin 102, pika 1, shkronja “dh”, nenin 105, pika 1, shkronja “d”, nenin 110 të ligjit “Për statusin”, për veprime që kanë sjellë përfitim të padrejtë për palën në proces dhe janë kryer në kundërshtim me ligjin.

Në këtë procedim disiplinor Këshilli ka gjetur të bazuara përfundimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë se magjistrati ka vendosur uljen e dënimit në kohën që kërkuesi ka pasur statusin e të paraburgosurit, në kundërshtim me nenin 63 të ligjit nr. 8328/1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”. Gjithashtu, janë gjendur të bazuara përfundimet se neni 63 i ligjit nr.8328/1998, i ndryshuar, ka parashikuar të drejtën e të dënuarit për të kërkuar ulje dënimi vetëm për periudhën 12-mujore, dhe se në dhënien e vendimit magjistrati ka aplikuar uljen e njëkohshme të dënimit në një kohë që dispozita parashikon se kjo e drejtë, për subjektet përfitues, ushtrohet në çdo vit të vuajtjes së dënimit dhe jo për çdo vit të vuajtjes së dënimit, duke u vlerësuar qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit.

Me vendimin nr. 346, datë 27.07.2022 të Këshillit, në zbatim të parashikimeve të neneve 151, pika 1, shkronja “a” dhe 155 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve”, ndryshuar, është vendosur pezullimi nga detyra e magjistratit Z.V. Procedura administrative është iniciuar kryesisht nga Komisioni Disiplinor, bazuar në informacionin e njoftuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në lidhje me 2 (dy) procedimet e tjera disiplinore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka proceduar me dhënien e një vendimi jo përfundimtar dhe ka ende në shqyrtim procedimin disiplinor të depozituar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datë 23.11.2022, ndaj magjistratit S.U.

Konkretisht, me vendimin nr. 436, datë 25.10.2022 është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit {...}, deri në marrjen formë të prerë të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me të cilin është disponuar dhënia e masës disiplinore “Shkarkimin nga detyra”, bazuar në nenin 58, pika 1 dhe në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Lidhur me të dhënat mbi proceset gjyqësore me palë ndërgjyqëse Këshillin e Lartë Gjyqësor:

Këshilli i Lartë Gjyqësor përgjatë vitit 2022, ka qenë palë ndërgjyqëse në dy procese gjyqësore të zhvilluara në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, me objekt shfuqizimin e vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendime të marra në kuadër të procedimeve disiplinore të filluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në vitin 2020.

Juridiksioni dhe kompetenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në kuadër të Juridiksionit Disiplinor, janë parashikuar në nenin 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas së cilës: “Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.”

Ankimet e regjistruara në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit në kuadër të juridiksionit të tij disiplinor, janë vlerësuar nga ky Kolegj se do të gjykohen sipas dispozitave të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, për sa i përket natyrës e procedurës së gjykimit, si një gjykim kushtetues, i ndryshëm për nga natyra me gjykimin që Kolegji i Posaçëm i Apelimit bën në rastet kur ai gjykon sipas juridiksionit të tij rivlerësues.

Konkretisht, gjatë vitit 2022, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë zhvilluar dhe përfunduar me vendim përfundimtar të formës së prerë proceset disiplinore si më poshtë:

1. Çështja e juridiksionit disiplinor nr. 4/2021, datë 21.05.2021, ku Këshilli i Lartë Gjyqësor është thirrur me cilësinë e subjektit të interesuar, bashkë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, me kërkues magistraten {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe me objekt shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 92, datë 17.03.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Çështja është aktualisht me status të përfunduar me vendimin nr.2, datë 31.05.2022 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me të cilin është disponuar me mospranimin e ankimit të magistratit.

Në arsyetimin e Kolegjit tërheqin vëmendjen disa qëndrime të tij në lidhje me disa aspekte që duhet të mbahen në konsideratë nga Këshilli në trajtimin e çështjeve disiplinore në të ardhmen. Në lidhje me nenin 135 të ligjit “Për statusin”, Kolegji arsyeton se përfshirja e marrëveshjes së përbashkët të pranimin në kreun për procedurat hetimore, rezulton se ajo është një procedurë që mundësohet kryesisht gjatë fazës së hetimit disiplinor. Roli i KLGJ-së është ai i “certifikuesit” të kësaj marrëveshjeje, pasi ka vlerësuar përmbushjen e kriterëve formale dhe ligjore. Por parashikimi në pikën 1 të nenit 135 – në çdo kohë mund të dakordësojnë marrëveshjen – në një interpretim të zgjeruar, mundëson që me dakordësinë të dy palëve, kjo marrëveshje të lidhet dhe në faza të mëvonshme, gjatë procedimit disiplinor. Mungesa e dakordësisë për marrëveshje nuk prek të drejtat e magistratit në drejtim të cenimit të standardeve të procesit të rregullt të magistratit, për sa kohë që procesi i rregullt garantohet në të gjitha elementet e tij, gjatë gjithë fazave të hetimit dhe procedimit disiplinor.

Gjithashtu, në këtë rast Kolegji ka vlerësuar të pabazuar pretendimin se masa disiplinore e “shkarkimit nga detyra” është vendosur pa ligj. Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 140, pika 2 e Kushtetutës, Kolegji ka çmuar se kjo dispozitë në mënyrën si është formuluar, në rastin e kryerjes së shkeljeve të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, nuk i ka dhënë mundësi delegimi ligjit për të përcaktuar masën disiplinore, por është shprehur qartë se këto raste përbëjnë shkaqe kushtetuese që shërbejnë për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit. Në këtë mënyrë,

kushtetutëbërësi, në përcaktimin e shkaqeve me vërtetimin e të cilave zbatohet direkt masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, e ka konsideruar nenin 140 si një dispozitë drejtpërdrejt të zbatueshme, në frymë dhe në harmoni me parashikimin e nenit 4, pika 3 e Kushtetutës.

Së fundi, Kolegji ka konkluduar se mungesa e ankimit për vendimet të cilat vlerësohen se përbëjnë shkelje shumë të rëndë disiplinore, nuk e përjashton apo e lehtëson përgjegjësinë e magjistratit për shkeljet e kryera, por mbetet një vlerësim që duhet bërë për veprimtarinë e pjesëmarrësve të tjerë në proceset gjyqësore, që nuk është objekt shqyrtimi nga KLGJ-ja. Dhënia e vendimeve haptazi në kundërshtim me ligjin, që sjellin perceptimin e publikut se drejtësia nuk po bëhet, ndikojnë në sistemin gjyqësor në tërësi dhe, rrjedhimisht, edhe në vetë besimin që publiku vendos në të.

2. Çështja e juridiksionit disiplinor nr.2/2021, datë 26.03.2021. Çështja ka filluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, mbi bazën e ankimit të magjistratit {...}, më detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, me objekt shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 633, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë proces, Këshilli është thirrur nga Kolegji me cilësinë e subjektit të interesuar. Edhe kjo çështje është me status të përfunduar me vendimin nr.3, datë 07.12.2022 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur mospranimi i ankimit të magjistratit.

Në këtë vendim Kolegji ka vlerësuar se mungesa e kontrollit përfundimtar dhe të plotë të sistemit gjyqësor mbi vendimmarrjen që është konsideruar se ka përbërë shkelje disiplinore, interpretimit dhe analizës së ligjit penal të kryer nga gjyqtari (referuar çështjes konkrete), duke vlerësuar se marrja e një vendimi për procedimin disiplinor të ankuesit do të ishte e cenueshme pa pasur një qëndrim përfundimtar të Gjykatës së Lartë mbi këtë çështje, si gjykata kompetente për çështjet e ligjit, sjell pezullimin e gjykimit të çështjes së juridiksionit disiplinor deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes penale lidhur me rekursin depozituar në Gjykatën e Lartë.

Mbi pretendimin e ankuesit, Kolegji ka theksuar se në zbatim të neneve 30-33 të Rregullores së KLGJ-së, “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, në të cilat parashikohen procedurat për shqyrtimin paraprak të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor, Komisioni Disiplinor dhe relatori i caktuar me short bëjnë vetëm

verifikimin e kriterëve formale të kërkesës së ILD-së, sipas nenit 133 të ligjit nr. 96/2016, si dhe gjatë veprimeve paraprake për përgatitjen e çështjes për seancë dëgjimore, përgatisin dhe paraqesin në relacion çështjet për të cilat do të ketë vendimmarrje nga mbledhja plenare e Këshillit dhe nuk u japin zgjidhje ankesave apo kërkesave të magjistratit, por vendosin vetëm për përcjelljen e tyre mbledhjes plenare të Këshillit.

Lidhur me pretendimin për mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, Kolegji ka vlerësuar se Komisioni Disiplinor ka kryer verifikimin e kriterëve formale të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor, duke vlerësuar midis të tjerave dhe kushtet e parashikuara në nenin 139 të ligjit nr. 96/2016, për mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore.

Në përfundim, Kolegji, bazuar në të gjitha konkluzionet e arritura pas analizës përkatëse, çmon se është i drejtë qëndrimi i KLGJ-së, për sa ka konkluduar se: (i) nga ana e magjistratit janë ndërmarrë veprime/mosveprime, të cilat kanë të bëjnë me mosrespektim të rëndë dhe të vazhduar të legjislacionit material dhe procedural penal, duke mos respektuar parashikimet e neneve 3, 64 dhe 65 të Kodit Penal, si dhe parashikimet e vendimeve nr. 4/2003 dhe nr. 2/2015, të Kolegjeve të Bashkuara, të Gjykatës së Lartë; (ii) nuk janë respektuar dispozitat penale me karakter urdhërues, të cilat parashikojnë kriterë me karakter objektiv, ndalues dhe me një përmbajtje të drejtpërdrejtë dhe lehtësisht të kuptueshme, ku përvoja e gjatë profesionale në detyrë e magjistratit e lejon të interpretojë dhe zbatojë drejt këto dispozita; (iii) gjatë dhënies së vendimit arsyetimi i bërë nga ana e magjistratit nuk është në përputhje me provat e administruara në gjykim dhe në përputhje me faktet dhe rrethanat që janë provuar gjatë procesit gjyqësor, si dhe faktet dhe rrethanat janë parashtruar dukshëm në mënyrë të shtrembëruar dhe vetëm për t'ju përshtatur plotësisht të kërkesave formale (me natyrë objektive), si dhe atyre me natyrë subjektive të nenit 64 dhe nenit 65 të Kodit Penal; (iv) nga ana e magjistratit nuk është mbajtur në konsideratë, krahas jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, në lidhje me këtë institut të së drejtës penale, edhe vetë praktika e tij e ndjekur gjatë trajtimit të kërkesave me objekt “Lirim me kusht”; (v) këto veprime/mosveprime të tij janë kryer në mënyrë drejtpërdrejtë, të vazhduar, të vullnetshme dhe të pajustificuar brenda të njëjtit proces gjyqësor.

Lidhur me bashkëpunimin ndërinstitucional me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë:

Bashkëpunimi ndërinstitucional, në aspektin e rritjes së cilësisë së vendimmarrjes dhe performancës së Këshillit të Lartë Gjyqësor në çështjet me natyrë disiplinore ka vijuar të mbetet në vëmendje të veçantë të Komisionit Disiplinor. Veçanërisht janë vlerësuar tryezat e përbashkëta të organizuara me institucione të tilla të pavarura si Këshilli i Lartë të Prokurorisë apo Inspektori i Lartë të Drejtësisë, të cilat kanë pasur si qëllim diskutimin e rolit të shërbimeve të inspektimit, si garantues për funksionimin e drejtë dhe të pavarur të sistemit të drejtësisë dhe magjistratëve, sipas standardeve evropiane dhe praktikave më të mira ndërkombëtare. Konkretisht në 24 qershor 2022, me ftesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është zhvilluar Konferenca Ndërkombëtare me temë “Interesi publik në administrimin e drejtësisë dhe pavarësia e magjistratëve”, organizim i mbështetur edhe nga programi i përbashkët i BE-së dhe KE-së “Instrumenti Horizontal”.

Përfundime:

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, Komisioni Disiplinor si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor kanë treguar përgjegjshmëri dhe kujdes në zbatueshmërinë në praktikë, të gjithë kuadrit normues për procedurat disiplinore, duke përfunduar brenda afateve ligjore dhe të arsyeshme të gjitha procedurat disiplinore të paraqitura për shqyrtim.

Gjatë vitit 2023, në objektiv të Komisionit Disiplinor si dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbetet përfundimi i procedimeve disiplinore, të cilat janë të pezulluara për shkak të dualitetit të procedimeve disiplinore ndaj magjistratëve, për periudhën e përkohshme, në kushtet kur është vlerësuar se magjistrati nuk mund të jetë në të njëjtën kohë nën disa hetime ose procedime disiplinore të veçanta, kjo për shkak të ndikimit që ato kanë lidhur me sanksionin disiplinor sipas kritereve të përcaktuara në nenin 115, të ligjit “Për statusin”.

Në plotësim të rekomandimeve të vendosura në Rezolutën e Kuvendit për vitin 2022, Komisioni Disiplinor synon të arrijë, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe komisionin përkatës, finalizimin në vitin 2023 të një drafti me rregulla të përbashkëta për bashkimin e procedimeve, për rastet kur një gjyqtar ose një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore.

Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës në drejtim të organizimit të trajnimeve të përbashkëta, ka qenë në fokus të Komisionit me anë të propozimit të temave trajnuese me objekt çështje të rëndësishme të disiplinës.

Ushtrimi i veprimtarisë së Komisionit Disiplinor, në kuadër të politikave të Këshillit të Lartë Gjyqësor për rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së gjyqtarëve, paraqet një rëndësi të veçantë, për shkak dhe të natyrës së procedurave në kompetencë të tij, të cilat kanë një impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve. Kjo veprimtari duhet të ushtrohet gjithnjë në pajtim dhe respektim të parimit të pavarësisë së gjyqtarit gjatë ushtrimit të funksionit të tij. Respektimi i këtij parimi është një kusht i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Pavarësia e gjyqtarit nuk është një privilegj, por një nga detyrat themelore të gjyqtarëve dhe të gjykatës, që rrjedh nga të drejtat e njeriut për të pasur një arbitër të paanshëm në një konflikt, të garantuar nga Kushtetuta.

Ky ishte Kryetare, shkurtimisht, raporti i përgatitur nga Komisioni Disiplinor.

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Shehu!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutim mbi përmbajtjen e raportit apo pyetje, ftoj kolegët për të votuar raportin e veprimtarisë së Komisionit të Disiplinës.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit Disiplinor gjatë vitit 2022”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.02.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën për vitin 2022”, përgatitur nga znj. {...}.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 13:24.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
7. **{...}, Këshilltar për Etikën në gjykata.**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën për vitin 2022”, për gatitur nga znj. {...}.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër, që edhe kjo, duke qenë se kjo mbledhje ishte dedikuar raporteve vjetore të komisioneve, kemi ftuar për të raportuar gjithashtu edhe Këshilltarin e Etikës, znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Lartë, e cila do të na raportojë lidhur me veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën për vitin 2022.

Përshëndetje {...}!

{...}: Përshëndetje!

Dëgjohem?

Naureda Llagami: Po, dëgjoresh shumë mirë.

Mirë se na erdhe në Këshill!

{...}: Mirë se ju gjeta!

Naureda Llagami: Atëherë, shkurtimisht lidhur me veprimtarinë, në cilësinë e Këshilltarit për Etikën.

{...}: Faleminderit!

Në radhë të parë, ju kërkoj ndjesë që nuk pata mundësi të jem prezent në mbledhje dhe ju falënderoj shumë për mirëkuptimin, por ngarkesa... ishte e pashmangshme nga ana ime.

Unë kam bërë një raportim të përmbledhur të veprimtarisë së Këshilltarit të Etikës për vitin 2021, kështu që në vijim, në mënyrë të përmbledhur po citoj disa nga elementët kryesorë që besoj ia vlejnjë të evidentohen.

Në vijim të raportimit për punën e zhvilluar në vitin 2021, që në hyrje më duhet të theksoj faktin, fatkeqësisht, që komunikimi me gjyqtarët ka qenë jo në nivelin e duhur. Pas miratimit të Kodit të Etikës Gjyqësore, që në fakt duhet pranuar, që është bërë në prill të 2021, megjithatë pritshmëritë ishin për një qasje tjetër dhe për një nivel më intensiv komunikimi.

Me miratimin e Kodit të Etikës filloi puna nga ana e Këshilltarit të Etikës për evidentimin e dilemave etike me qëllim përgatitjen e manualit siç përcaktohet në nenin 83 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Por vështirësia që kam hasur gjatë këtij viti është pikërisht mungesa e komunikimit me gjyqtarët dhe duke pasur një nivel komunikimi pothuajse minimal, për të mos thënë zero, kam ndeshur në shumë vështirësi për identifikimin e problematikave që lidhen me çdo parim etik që parashikohet në Kodin e Etikës Gjyqësore. Kjo vështirësi... sepse mund të evidentohen dilema, por pastaj kur nuk qasen me një këndvështrim pak më konkret dhe praktik, mund të kthehen në trajtime të gjata teorike dhe pikërisht për të shmangur këtë dhe kjo është vështirësia kryesore që ka penguar edhe ecurinë me hartimin e manualit.

Gjatë vitit 2022 kam pasur komunikim me dy gjyqtarë të cilët kanë kërkuar një mendim paraprak në lidhje me përfshirjen e tyre në situata të caktuara duke kërkuar mendimin në lidhje me standardin e etikës gjyqësore apo rregullat e sjelljes që duhet të kenë ato në raport me këto dy situata konkrete. Këto raste nuk kanë qenë të tilla në vlerësimin tim, që të diktonin nevojën e hartimit të një opinionit të përgjithshëm (siç

ndodhi në vitin 2021), por natyrisht ato do mbahen në konsideratë në manual dhe do të jenë pjesë e dilemave etike, natyrisht pa cenuar konfidencialitetin.

Me qëllim lehtësimin e komunikimit me gjyqtarët, në faqen zyrtare të KLGJ-së është krijuar një rubrikë dedikuar Këshilltarit të Etikës dhe ky informacion i është përcjellë nëpërmjet postës elektronike çdo gjyqtari. Çdo gjyqtar nuk është në dijeni thjesht të postës elektronike por edhe në opinionet dhe në çdo lloj komunikimi tjetër me ta i është bërë prezent dhe i është vënë në dukje që ky komunikim “online” apo nëpërmjet postës do të jetë gjithsesi konfidencial. Megjithatë, pavarësisht kësaj lehtësie në komunikim, përsëri niveli i komunikimit ka qenë pothuajse zero.

Unë kam evidentuar disa shkaqe që mund të jenë si pasojë e kësaj mungese komunikimi, e para natyrisht që është ajo që edhe ju vetë e keni evidentuar, që është ngarkesa në gjyqësor për shkak të situatës, por ka edhe një lloj ngurrimi nga vetë gjyqtarët, për të diskutuar çështje që mund të lidhen me shkelje të etikës. Ndoshta kjo vjen edhe sepse nuk është kuptuar sa duhet roli i Këshilltarit të Etikës që është një rol i shkëputur nga KLGJ-ja apo nga çdo lloj iniciative tjetër disiplinore. Për këtë shkak unë edhe në raport e kam theksuar dhe e ritheksoj që çdo gjyqtar mund të aksesojë postën elektronike dhe të komunikojë drejtpërdrejt me mua si Këshilltar i Etikës për çdo problematikë apo dilemë që ato ndeshin gjatë ushtrimit të funksionit të tyre.

Mendimet dhe opinionet e Këshilltarit të Etikës jo vetëm që janë këshillimore por duhen pasur në konsideratë, jo vetëm sot, por në vazhdimësi, që duhen vlerësuar gjithmonë, që ndikojnë vetëm pozitivisht në ushtrimin e funksionit nga ana e gjyqtarëve me qëllim që të shmangen ato lloj sjelljesh që vënë në dyshim pavarësinë apo paanësinë e tyre si dhe ushtrimin e veprimtarisë sidomos jashtë gjyqësorit në përputhje me standardet etike.

Janë hartuar dy opinione të vitit 2021, që lidhen me përdorimin e telefonit celular nga gjyqtarët gjatë seancave gjyqësore, si dhe kufijtë e përdorimit të rrjeteve sociale. Këto janë publikuar jo vetëm në faqen zyrtare të KLGJ-së, tek rubrika që i është dedikuar Këshilltarit të Etikës, por edhe janë përcjellë nëpërmjet postës elektronike çdo gjyqtari. Qëllimi i këtij komunikimi ishte që ato të reagonin dhe të kishin një lloj reagimi, meqenëse ato dy opinione ishin si një hap i parë për të nxitur debate dhe diskutime mes gjyqtarëve, për të dhënë edhe sugjerime për përditësimin e tyre.

Ka pasur disa reagime në fakt, komente apo reagime, jo diçka specifike, të cilat natyrisht unë do t'i evidentoj pastaj në përgatitjen e manualit, por jo një reagim konkret që të përditësohet apo të reflektohet diçka ndryshe në këto opinione.

Megjithatë, sidomos në përdorimin e rrjeteve sociale më duhet të them që konstatohet fakti që gjyqtarët janë aktiv, janë shumë aktiv në përdorimin e rrjeteve sociale dhe në disa raste kam vënë re, por edhe nga kolegë të tjerë më është vënë në dukje që mund të jenë edhe në kufijtë e cenimit të rregullave të etikës, natyrisht nuk shkojmë deri aty, dhe për këtë, në raportimin tim kam sugjeruar që ndoshta është me vend ndërhyrja e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të nxjerrë një udhëzim të përgjithshëm në lidhje me këtë temë, apo ndoshta një amendim të Kodit të Etikës në lidhje me dispozitën që parashikon përdorimin, që nuk ndalohet përdorimi i rrjeteve sociale, por për kujdesin që gjyqtari duhet të tregojë në aksesin në mediat sociale.

Një rol i rëndësishëm në veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën është bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës, janë bërë përpjekje dhe janë përfshirë disa tema që lidhen me Kodin e Etikës Gjyqësore në programin e trajnimit vazhdues. Por ndonëse janë përfshirë disa aktivitete dhe një temë e posaçme që është posaçërisht për Kodin e Etikës Gjyqësore, duke parë edhe reagimet dhe komunikimet jo në nivelin e duhur të gjyqtarëve për temat etike gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, vlerësojmë që ka vend për një përmirësim të mëtejshëm të këtij bashkëpunimi. Shkolla e Magjistraturës ka një procedurë të caktuar të përzgjedhjes së temave dhe të ekspertëve, megjithatë sugjeroj që ky komunikim mund të lehtësohet akoma më tepër me ndërhyrjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, pavarësisht përpjekjeve që janë bërë nga ana ime në zbatim të nenit 83 të ligjit “Për organet e qeverisjes gjyqësore”.

Ashtu siç e tha edhe kryetarja e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, puna për hartimin e manualit vazhdon dhe këtu gjej rastin të falënderoj Komisionin e Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për mbështetjen që më ka dhënë gjatë këtij viti, për diskutimet që kemi bërë në lidhje me përgatitjen e këtij manuali. Natyrisht, për të qenë një manual sa më informues dhe sa më i plotë, vlerësoj që kjo nuk mund të ngelet vetëm në punën e Këshilltarit të Etikës dhe kërkohet një mbështetje më e madhe, edhe nga ana e KLGJ-së, por duke shpresuar sidomos në lehtësimin e komunikimit me gjyqtarët apo qoftë edhe në një bashkëpunim

më të mirë me Shkollën e Magjistraturës për ta bërë pak më të qartë rolin dhe rëndësinë që ka Kodi i Etikës, roli i Këshilltarit të Etikës dhe manuali që do të përgatitet. Kështu që në këtë raportim, më ngelet të rithekoj edhe një herë faktin/domosdoshmërinë që kam për zbatimin e pikës 7 të nenit 83 të ligjit 115/2016. Është shumë e nevojshme që manuali i iniciuar të përfundojë në një kohë sa më të shpejt dhe të arsyeshme dhe të bëhet publik me qëllim që të marrim edhe një “feedback”, me shpresën që edhe komunikimi me gjyqtarët do të jetë pak në nivele më të kënaqshme vitin që po fillon.

Në këtë pikë në fakt gjej rastin (e kam shënuar në raportim dhe më duhet ta them edhe këtu në këtë mbledhje) të falënderoj Qendrën e Dokumentacionit pranë Gjykatës së Lartë, z. {...} në veçanti, që më ka ndihmuar shumë në kërkimin e disa materialeve që lidhen me standardet etike ndërkombëtare dhe përkthimin e tyre, pasi për shkak edhe të faktit që unë nuk jam e shkëputur nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarës, ka qenë shumë e vështirë për t’i menaxhuar dhe për t’i bërë të gjitha gjërat pra edhe gjetjen e materialit edhe përkthimin, dhe pastaj përditësimin dhe përpilimin e dilemave etike me pyetje dhe përgjigje, siç kërkohet për përgatitjen e këtij manuali.

Duke ju falënderuar shumë, unë këto kisha në mënyrë të përmbledhur.

Por meqenëse, siç ju thashë, komunikimi fatkeqësisht nuk ka qenë në nivelin e kënaqshëm, duke shpresuar që këtë vit të kemi një produkt pak më konkret dhe të fillojmë diskutimet, dhe të kemi një komunikim më të mirë me gjyqtarët.

Ju falënderoj shumë për vëmendjen tuaj.

Në qoftë se keni komente apo diçka.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit {...} lidhur me raportimin mbi veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën për vitin që kaloi.

Atëherë, unë do të ftoja...

Alban Toro: Do kisha unë një pyetje.

Naureda Llagami: Po, Alban!

Zoti Toro po bën një pyetje {...}!

Alban Toro: Është një pyetje lidhur me fushën që mbuloni.

Përdorimi i faqes zyrtare të gjykatës, për të mbrojtur subjektet të cilët nuk ushtrojnë funksionet e gjyqtarit, a është në përputhje me standardet e etikës.

{...}: Tani, ju e doni këtë pyetjen kështu? Se duhet të evidentojmë pak...

Alban Toro: Pa kazus, pa emra, pa gjë. Thjesht kam një pikëpyetje në lidhje me këtë, meqenëse jeni specializuar në këtë fushë.

{...}: Ju faleminderit për pyetjen!

Nuk jam ndoshta shumë e përgatitur për ta dhënë direkt këtë pyetjen.

Në pamje të parë... Pra pyetja është që në qoftë se në faqen e gjykatës mund të mbrohet një gjyqtar?

Alban Toro: Më fal se audio erdhi me mangësi.

{...}: Më fal!

Pyetja është: Në faqen e gjykatës një gjyqtar...?

Alban Toro: Po! Përdorimi i faqes zyrtare të gjykatës, për të mbrojtur subjekte që nuk janë, apo nuk ushtrojnë funksionin e gjyqtarit.

{...}: Domethënë, është një temë shumë e gjerë. Natyrisht është një pyetje që unë do preferoja shumë që të evidentohet dhe do të ishte një pyetje dhe një përgjigje për t'u përfshirë në manual. Në pamje të parë, ndoshta, përgjigja ime është që faqja e gjykatës është për veprimtarinë e gjykatës. Por pastaj duhet parë kush është ky subjekt? Çfarë lidhje ka? Pse ka reaguar faqja zyrtare e gjykatës sepse ka një mënyrë menaxhimi të faqes web të gjykatës; pse ka reaguar; pse është bërë pjesë? Domethënë, duhet parë në tërësi problematika. Në pamje të parë duket që nuk ka lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së gjykatës. Nuk mund të jap një përgjigje, nëse është apo jo në përputhje me etikën.

Alban Toro: Të falënderoj! Sepse edhe unë ndaj të njëjtin opinion me ju. Megjithatë, në temat e ardhshme që ju mund të zhvilloni, mund ta përfshini si kazus hipotetik.

{...}: Unë po e mbaj shënim.

... sepse duhet parë edhe kush e menaxhon.

...se ne flasim për Kodin e Etikës Gjyqësore që lidhet me sjelljen e gjyqësorit (e gjyqtarëve) dhe duhet parë kush e menaxhon faqen, nëse është kryetari i gjykatës, është kancelari, pra kujt i bie le të themi ose kush e ka atë detyrimin për të bërë këto reagime, a është gjyqtari për mediat, pra varet.

Faleminderit për çështjen.

Është me shumë interes dhe e mbajta shënim.

Alban Toro: Faleminderit!

Naureda Llagami: Ndonjë pyetje tjetër?

Nëse jo, atëherë Albana të falënderoj shumë për prezencën virtuale këtu dhe për sqarimet që na dhe.

{...}: Ju kërkoj shumë ndjesë që nuk isha pranë jush.

Naureda Llagami: Mund të vazhdoni, për të lejuar Këshillin që të miratojë raportin. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën për vitin 2022”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.02.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarës së Gjykatës Administrative të Apelit të znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 13:24.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës Administrative të Apelit të znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e fundit për mbledhjen e sotshme që ka të bëjë me ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës Administrative të Apelit të znj. {...}. Fjalën ia jap zotit Toro, i cili shkurtimisht do relatojë projekt-aktin.

Alban Toro: Edhe unë si kolegët, shkurtimisht, 9 faqe do mundohem t’i pasqyrojë në mënyrë të sintetizuar, pasi në shumicën e tyre do të gjeni në mënyrë kronologjike fazat që kanë shërbyer për të realizuar procedurën e ngritjes në detyrë të znj. {...} dhe për të mos e zgjatur, mbi propozimin e relatorit, konform neneve 147, 147/a të Kushtetutës, nenet 86, 97 e 98, të Ligjit nr.115/2016, pikat 9, 10, 14 të nenit 48 të ligjit nr. 96/2016, si dhe vendimit nr.70, datë 07.02.2020, nga ana e Këshillit, më herët, me vendimin nr. 68, datë 09.02.2023 është vendosur miratimi i renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 571, datë 07.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1) Znj. {...}

2) {...}.

Menjëherë mbas kësaj procedure, vendimi i është bërë i ditur të dy kandidatëve të cilët në rrugë elektronike konfirmuan se nuk do të ushtronin të drejtën e ankimit.

Për rrjedhim, në kushtet e zbatimit të pikës 68 të vendimit 70/2020, përgatita këtë projektvendim, në diapozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës Administrative të Apelit të znj. {...}.

2. Përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm të gjyqtares znj. {...}, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

3. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.03.2023.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Toro!

Atëherë, nëse ka diskutim nga kolegët?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Po!

Brikena Ukperaj: Lidhur me datën e fillimit të efekteve, pse është vendosur data 1 mars? Sot jemi 23. Një javë, për çfarë arsye?

Alban Toro: Në kushtet kur zonja {...} është me leje për shkak të fëmijës, i dhënë mundësi që të organizojë punën. Nuk ka ngarkesë gjykata. Thjesht është çështje humane, për t'i dhënë mundësi të stabilizojë problemet me fëmijën, duke qenë se ka konfirmuar që është e gatshme të rikthehet në detyrë.

Brikena Ukperaj: Po pra, ideja është që vazhdimi i lejes së lindjes nuk e pengon që të shkojë që nesër në punë. Ajo quhet gjyqtare e Gjykatës së Apelit Administrativ dhe vazhdon lejen e lindjes për aq sa mundet.

Alban Toro: Ky ishte qëllimi. Meqenëse kemi një pasqyrim të vullnetit të saj për të vijuar punën pas këtij momenti, i dhamë mundësi të organizohet që në datën 1 të jetë e gatshme të përmbushi detyrat.

Brikena Ukperaj: Të përgatitet emocionalisht.

Po dakord. S’kam pyetje.

Naureda Llagami: E hedhim në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës Administrative të Apelit të znj. {...}.
2. Përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm të gjyqtares znj. {...}, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.
3. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.03.2023.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës

Administrative të Apelit, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Përpara se ta mbyllim, nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës i janë përcjellë të gjithë anëtarëve kërkesat për caktimin e gjyqtarëve në gjykatat në nevojë. Duke i lënë mundësi stafit sa të bëhen gati, për 30 minuta të futemi për t'i shqyrtuar edhe ato kërkesa “online”.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor